

Raport Studimor

**ANALIZA E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR DHE PRAKTIKAVE
INSTITUCIONALE NË LIDHJE ME RIINTEGRIMIN E LUFTËTARËVE TË
HUAJ TË KTHYER NGA ZONAT E KONFLIKTIT DHE FAMILJARËT E
TYRE SI EDHE PERSONAVE TË TJERË TË RADIKALIZUAR APO NË
RREZIK RADIKALIZIMI**

**PËRQASJA NDAJ DISA PRAKTIKAVE RAJONALE PËR TË IDENTIFIKUAR
PRAKTIKAT E MIRA**

Ky raport është përgatitur në kuadër të nismës ““Lënia e së kaluarës pas: Rritja e qëndrueshmërisë ndaj ekstremizmit të dhunshëm përmes mbështetjes dhe edukimit”, i cili zbatohet nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, në bashkëpunim me Linjën për Këshillimin e Grave dhe Vajzave, mbështetur financiarisht nga GCERF. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe në asnjë rast nuk reflekton apo përfaqëson domosdoshmërisht mendimin apo qëndrimin e organizatës partnere apo GCERF.

Përgatiti Raportin Studimor:

Znj. Zyhrada Kongoli , Eksperte kryesore e jashtme ligjore e KShH

Ekspertët e rajonit:

Znj. Shukrije Gashi, Eksperte/Trajnuese e P/LEDh, Republika e Kosovës

Znj. Besa Arifi, Profesore e Drejtës Penale dhe Kriminologjisë, Instituti i Kërkimeve Studimore Max Van Der Stoel, Universiteti i Evropës Juglindore, Republika e Maqedonisë së Veriut

Znj. Melisa Hasanović, Eksperte, Bosnje-Hercegovinë

Znj. Izabela Kisic, Drejtore Ekzekutive e Komitetit Serb të Helsinkit

Përktheu kontributin e ekspertëve të rajonit:

Z. Anri Pashaj, Përkthyes

Kontribuan në rishikimin dhe redaktimin:

Z. Njazi Jaho, Këshilltar Ligjor, KShH

Znj. Ardita Kolmarku, Drejtuese e Klinikës së Ligjit/Menaxhere Projektesh, KShH

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor: © Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Nëse jeni të interesuar për këtë raport, mund të kontaktoni Komitetin Shqiptar të Helsinkit në adresën e mëposhtme:

Rr. Brigada e VIII-të, Pallati “Tekno Projekt” Shk 2 Ap 10, Tirana-Albania

Kutia Postare nr.1752; Tel: 04 2233671; Cel: 0694075732;

E-mail: office@ahc.org.al ; Web site: www.ahc.org.al

Tetor 2023

Përmbajtje

Shkurtime.....	5
Përkufizime.....	6
KREU I	8
PRAKTIKA LEGJISLATIVE DHE INSTITUCIONALE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË.....	8
Përmbledhje Ekzekutive	8
Analiza e thelluar e rastit të Shqipërisë	8
Analizë e qasjeve të zbatuara në vendet e rajonit me qëllim identifikimin e praktikave të mira dhe të aspekteve që duhen përmirësuar.....	11
Qëllimi dhe Objektivat	12
Metodologjia	13
Analiza Ligjore	14
Kuadri Institucional.....	21
Analiza e kapaciteteve institucionale.....	24
Qendra Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH).....	24
Drejtoria e Anti-terrorit ne Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit	30
Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtën e Fëmijës (ASHDMF).....	31
Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (DPB)	32
Shërbimi i Provës	35
Njësitë e vetëqeverisjes vendore/Bashkitë.....	35
Praktika të vendeve të tjera të rajonit në riintegrimin e Luftëtarëve të Huaj të Kthyer dhe Personave të Radikalizuar ose në rrezik radikalizimi	45
Gjetje dhe Rekomandime	49
KREU II.....	54
PRAKTIKA LEGJISLATIVE DHE INSTITUCIONALE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS.....	54
Prezantim	55
KORNIZA STRATEGJIKE DHE LIGJORE E KOSOVËS PËR LUFTËN KUNDËR EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM, RADIKALIZMIT DHE TERRORIZMIT	57
KUADRI STRATEGJIK.....	57
KUADRI LIGJOR	58
KUADRI INSTITUCIONAL	58
MODELET POZITIVE NË LIDHJE ME LEGJISLACIONIN NË KOSOVË LIDHUR PËR SA I TAKON EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM, IDENTIFIKIMIT DHE RIINTEGRIMIT TË LTH TË KTHYER	59

Përfundim	61
KREU III	63
PRAKTIKA LEGJISLATIVE DHE INSTITUCIONALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT	63
Hyrje	63
1. Evolucioni i qasjes ndaj LEDh në Maqedoninë e Veriut	65
2. Qasja legjislative dhe gjyqësore ndaj ekstremizmit të dhunshëm në Maqedoninë e Veriut	67
3. Krijimi i Strategjisë së Parë Kombëtare për LEDh (SKLEDh) dhe dokumenteve përkatëse	71
4. Sfidat e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për LEDh	74
5. SKLEDh-ja e dytë 2023-2027	75
6. Puna e Drejtorisë për Zbatimin e Sanksioneve	78
8. Përfshirja e shoqërisë civile	80
7. Krijimi i Strategjisë Kombëtare për Një shoqëri të Vetme dhe Ndërkulturalizëm	81
Rëndësia e konceptit "Një shoqëri dhe ndërkulturalizëm" për mekanizmat e PEDh	84
9. Praktika të mira	85
10. Sfidat	87
Hapat e ardhshëm	89
Veprat e cituara	90
KREU IV	95
PRAKTIKA LEGJISLATIVE DHE INSTITUCIONALE NË REPUBLIKËN E SERBISË	95
Hyrje	95
Legjislacioni	96
Luftëtarët e huaj dhe procedurat gjyqësore në Serbi	96
Luftëtarët e huaj terroristë në Siri	98
Programet e deradikalizimit, riintegritit dhe risocializimit	99
Riatdhesimi: Gratë dhe fëmijët në kampe në Sirinë verilindore	101
Përfundim	103
KREU V	104
PRAKTIKA LEGJISLATIVE DHE INSTITUCIONALE NË REPUBLIKËN E BOSJNE- HERCEGOVINË	104
1. Korniza legjislative në Bosnjë dhe Hercegovinë	104
2. Një shembull i praktikës së mirë	108
2.1. Përgatitja e familjes pritëse, komunitetit vendor dhe profesionistëve	109

2.2.	Pranimi dhe mbështjetja.....	110
2.3.	Vlerësimi i menjëhershëm i nevojave familjare dhe ndërhyrja	112
2.4.	Plani afatgjatë i mbrojtjes	114
3.	Sfida	115

Shkurtime

AKCESK	Autoriteti i Kontrollit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Shqipërisë
AMA	Autoriteti i Mediave Audiovizive
BE	Bashkimi Evropian
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
EDH	Ekstremizëm i dhunshëm
GCERF	Fondi Global i Angazhimit dhe Rezistencës së Komunitetit (Global Community Engagement & Resilience Fund)
GTN	Grupit Teknik Ndërsektorial
KiE	Këshilli i Evropës
KNFSH	Këshilli Ndërfetar Shqiptar
KVSP	Këshillat Vendore të Sigurisë Publike
LHT	Luftëtarët e Huaj Terroristë
NjMF	Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve
PIM	Plan Individual i Mbrojtjes
PMF	Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës
QKEDH	Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizimit
RRR	Rehabilitim, Ri-integrim dhe Ri-socializim
RSH	Republika e Shqipërisë
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Përkufizime

Rehabilitimi - Veprimtari të qëllimshme dhe të planifikuara që synojnë përmirësimin e marrëdhënies së individit me shoqërinë, nëpërmjet adresimit të nevojave individuale, shëndetësore dhe materiale si edhe dhënies së mbështetjes dhe mundësive për të fuqizuar individin dhe për të ndikuar në ndryshimin e sjelljeve destruktive në shoqëri;

Riintegrimi - Kthimi, vendosja dhe përfshirja e individit në komunitet e shoqëri nëpërmjet dhënies së mbështetjes psikologjike, sociale dhe ekonomike në mënyrë të vazhduar dhe në përputhje me nevojat individuale;

*Luftëtarë të huaj terroristë*¹ - Individë të cilët udhëtojnë drejt një shteti që nuk është shteti i tyre, i qëndrimit apo nënshtetësisë, me qëllim kryerjen, planifikimin, përgatitjen apo pjesëmarrjen në akte terroriste, ose ofrimin a përfitim të trajnimit terrorist, qoftë ai edhe në lidhje me një konflikt të armatosur;

Faktorë shtytës/nxitës - Faktorë të ndryshëm shoqërorë, ekonomikë, politikë, nacionalistë dhe ideologjikë që drejtojnë individët drejt radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm, të tillë si: marginalizimi, pabarazia, diskriminimi, persekutimi ose perceptimi i persekutimit, mundësia e kufizuar për arsim cilësor dhe të përshtatshëm, mohimi i të drejtave dhe lirive civile, dhe probleme të tjera mjedisore, historike dhe social-ekonomike;

Faktorë tërheqës - Faktorët që ushqejnë tërheqjen ndaj radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm dhe që lidhen me nevojat, narrativat dhe rrjetëzimet si në rastin e individëve dhe grupeve të mirëorganizuara të EDH, me ligjërimi imponuese dhe programe efektive, të cilat ofrojnë shërbime, të ardhura dhe/ose punësim në këmbim të anëtarësimit, dhe premtime që krijojnë iluzione për zgjidhjen e probleme për anëtarët e rinj .

Qasja mbarëshoqërore - Qasja që përfshin rolin dhe angazhimin e aktorëve shtetërorë, në nivel qendror dhe vendor, në sektorë të ndryshëm si dhe aktorë të shoqërisë civile, komuniteteve fetare, organizatave rajonale e ndërkombëtare, që kanë një rol në parandalimin dhe kundërshtimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm;

Aktorë të shoqërisë civile - Përfaqësues të grupimeve të ndryshme, komuniteteve fetare dhe shoqërore, të regjistruara si organizata jofitimprurëse ose jo, që përfaqësojnë një shumëllojshmëri rolesh dhe angazhimesh në jetën publike për mbrojtjen dhe promovimin e vlerave dhe objektivave të përbashkëta, mes të cilëve gratë, të rinjtë dhe komunitetet fetare kanë një rol të spikatur;

Radikalizëm - Procesi i përjasjes së individit ndaj opinioneve, ideve dhe pikëpamjeve ekstreme dhe adaptimit të pozitive radikale për çështje politike apo sociale. Radikalizimi mund të jetë i dhunshëm ose jo.

¹ Përkufizim i marrë nga Strategjia Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit dhe Planet e Veprimit 2023-2025;

Kundëradikalizëm – Tërësia e nismave dhe politikave ligjore, sociale, ekonomike dhe arsimore të hartuara posaçërisht për të frenuar individët e pakënaqur ose të radikalizuar që t'i drejtohen terrorizmit.

Deradikalizëm - Veprimtari që inkurajonë individin për të hequr dorë nga idetë ekstremiste dhe ndërtohet si një proces gjithëpërfshirës për të ndryshuar qasjen dhe sjelljet ekstremiste të një individi drejt riintegrit të tij në shoqëri;

Rezistencë e komunitetit - Aftësia e komunitetit për të rezistuar, për t'ju përgjigjur, kundërshtuar dhe rikuperuar ndaj ngjarjeve të dëmshme dhe negative që lidhen me radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm;

KREU I

PRAKTIKA LEGJISLATIVE DHE INSTITUCIONALE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Përmbledhje Ekzekutive

Analiza e thelluar e rastit të Shqipërisë

Fenomenet e radikalizmit dhe ekstremizmit kanë marrë një rëndësi më të madhe duke u kthyer në çështje prioritare në drejtim të ruajtjes së rendit e sigurisë në vend. Në këtë kuadër, ka një përpjekje të vazhdueshme për rishikimin e legjislacionit dhe përmirësimin e forcimit të kuadrit institucional që lidhet me adresimin e faktorëve nxitës drejt radikalizmit, kundëradikalizimin porse dhe rehabilitimin dhe riintegrimin e individëve të prekur ose në rrezik për t'u prekur nga këto fenomene.

Ndërsa ka një bazë të mjaftueshme ligjore dhe dokumentesh politike, në Shqipëri, që adresojnë parandalimin e kundërshtimit të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm, si dhe rehabilitimin dhe riintegrimin e individëve që kanë cilësi të ndryshme vulnerabiliteti, ka gjithmonë hapësirë për përmirësim në drejtim të zbatimit efektiv të këtyre rregullimeve dhe ndërveprimit eficient të aktorëve nëpërmjet shkëmbimit të informacionit dhe koordinimit të veprimeve. Në një kohë që fenomenet e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit kanë adaptuar forma të reja, është e rëndësishme që edhe legjislacioni dhe politikat t'i përgjigjen nevojave në ndryshim të përgjigjes ndaj këtyre fenomeneve edhe në kuadër të përpjekjeve të përbashkëta ndërkombëtare për të luftuar kërcënimin global të terrorizmit.

Në vitet e fundit, institucionet shqiptare të përfshira në kundërshtimin dhe ndëshkimin e këtij fenomeni por edhe në proceset rehabilituese dhe riintegruese, kanë krijuar një eksperiencë në rehabilitimin dhe riintegrimin e të kthyerve nga zonat e konfliktit në Siri/Irak. Në 5-vjeçarin e fundit, këto institucione kanë asistuar me sukses katër kthime nga këto zona dhe po asistojnë në mënyrë të vazhduar rehabilitimin e riintegrimin e individëve të kthyer. Kjo përvojë e grumbulluar i ka ndihmuar këto institucione të identifikojnë mangësitë dhe të kontribuojnë për të përmirësuar mekanizmat e ndërveprimit nëpërmjet miratimit të procedurave standarde të veprimit që i vendos këto ndërhyrje mbi bazë të parimeve e standardeve të unifikuara për të gjithë profesionistët e përfshirë.

Vlen të theksohet se mes të kthyerve në dhjetë-vjeçarin e fundit, nuk ka patur asnjë rast kthimi individë burra, të njohura nga burime zyrtare të konsideruar si luftëtarë të huaj terrorisë (LHT), por megjithatë është gjithmonë koha e duhur për të analizuar e vlerësuar situatën ligjore dhe institucionale me qëllim manaxhimin ligjor dhe efektiv të proceseve komplekse dhe kritike të rehabilitimit dhe riintegrimin të kësaj kategorie.

Termi “Luftëtarë të Huaj Terroristë” nuk ka patur një përkufizim në legjislacionin shqiptar, madje asnjë akt normativ nuk i referohet nominalisht kësaj kategorie ndërsa rradhit grupet vulnerabël që gëzojnë një mbrojtje të veçantë nga legjislacione të ndryshme që adresojnë mbrojtjen dhe integrimin e grupeve të pafavorizuara. Së fundmi, Strategjia Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit, e miratuar në vitin 2023, e ka përkufizuar këtë term dhe ndërmjet institucioneve ligjzbatuese dhe institucionet e tjera ka një kuptueshmëri të unifikuar për këtë kategori. Sidoqoftë, LHT dhe familjarët e tyre që kthehen nga zonat e konfliktit, përmbushin njëherësh disa faktorë vulnerabiliteti për shkak të rrethanave specifike dhe efekteve të traumës dhe për këtë arsye përfitojnë nga mbrojtja dhe programet sociale dhe mbështetëse të rregulluara nga legjislacioni për mbështetjen dhe fuqizimin socio-ekonomik të grupeve të pafavorizuara.

Që pas ndryshimeve në Kodin Penal, të miratuara në vitin 2014, ku veprat me qëllime terroriste kanë një rregullim më specifik në lidhje me pjesëmarrjen në veprime luftarake në një shtet të huaj, nuk ka ndodhur asnjë kthim i asistuar zyrtarisht nga shteti shqiptar apo i konfirmuar nga burime zyrtare i LHT burra, të identifikuar nga struktura e antiterrorizmit, nga zonat e konfliktit. Përpara kësaj periudhe, kjo kategori individësh janë trajtuar gjithashtu me masa riintegruese dhe rehabilituese, gjithmonë nën një monitorim të vazhduar për sigurimin e rendit dhe sigurisë publike të komuniteteve ku ishin vendosur në përputhje me legjislacionin dhe politikat për rendin publik.

Në përgjithësi, legjislacioni dhe politikat kombëtare të vendit tonë kanë adaptuar një qasje më “të butë” duke vendosur një fokus më të shtuar në masat dhe proceset rehabilituese dhe riintegruese për të kthyerit nga zonat e konfliktit, kryesisht gra e fëmijë. Në procesin e rehabilitimit dhe riintegrit të individëve të kthyer nga zonat e konfliktit, çështjet e sigurisë dhe ato të riintegrit socio-ekonomik kanë të njëjtën vlerë nga pikëpamja e zbatimit të ligjit. Procesi i tyre i ri-integrit duhet të fillojë pa vonesë dhe mund të vazhdojë normalisht, ndërsa institucionet ligjzbatuese vazhdojnë veprimtarinë e tyre investiguese, me qëllim mbledhjen e provave për një përfshirje të mundshme në vepra me qëllime terroriste të të kthyerve, gra e fëmijë mbi 14 vjeç. Sidoqoftë, çështjet e sigurisë duhet të kenë përparësi në kuadër të detyrimit kushtetues për garantimin e sigurisë së vendit, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ruajtjen e interesave kombëtare.

Në çdo rast, shteti ka përgjegjësinë për administrimin e çështjeve të sigurisë dhe të të drejtave të njeriut për të kthyerit nga zonat e konfliktit në mënyrë gjithpërfshirëse, efektive, të koordinuar dhe në bashkëpunim me aktorë jopublikë. Kjo do të thotë se është e rëndësishme të garantohet rendi e siguria publike e komuniteteve dhe shoqërisë në nivel kombëtar, si një konsideratë parësore. Në të njëjtën kohë, është thelbësore të parashikohen masa të qarta dhe efektive për t'u siguruar që të kthyerit të kenë mundësinë të integrohen përsëri në jetën socio-ekonomike, përfshirë

krijimin e mundësive për punësim, arsimim dhe ndihmë të vazhduar për rikthimin ose vendosjen e tyre të sigurt e qëndrueshme në komunitet.

Sfidat që shoqërojnë proceset rehabilituese dhe riintegruese të LHT dhe familjeve të tyre janë të shumta dhe të ndërlikuara. Para së gjithash, këto diktojnë nevojën për të përmirësuar koordinimin mes institucioneve në nivelet e ndryshme të qeverisjes qendrore dhe vendore dhe për të ndarë informacion dhe të dhëna në mënyrë efikase. Mënyra dhe frekuenca e shkëmbimit të informacioneve ndërmjet institucioneve të përfshira nevojitet të rregullohet më anë të një akti normativ pasi aktualisht ndodh në mënyrë sporadike ose me kërkesë të institucioneve të interesuara, të cilat megjithatë nuk e marrin në kohë informacionin e kërkuar.

Përveç kësaj, është e rëndësishme të rriten kapacitetet e strukturave të antiterrorit dhe profesionistëve të vijës së parë. Një rol të rëndësishëm kanë profesionistët e shëndetit mendor dhe punonjësit socialë që janë të përfshirë jo vetëm në identifikimin me qëllim parandalimin por edhe dhe më pas riintegrimin e personave të identifikuar si të radikalizuar.

Statusi ligjor dhe shtetësia e fëmijëve të lindur në zonat e konfliktit, të cilët kanë udhëtuar në Shqipëri pa dokumentacionin përkatës është një çështje që duhet adresuar. Ruajtja e konfidencialitetit për të dhënat personale të individëve subjekt i proceseve rehabilituese dhe riintegruese është një aspekt delikat i cili kontribuon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në sigurimin e të drejtave të fëmijëve dhe të drejtat e njeriut gjatë procesit të riintegrit të tyre në shoqëri por edhe në suksesin e këtyre proceseve.

Rishikimi i rolit dhe funksioneve të agjencive ligjzbatuese dhe institucioneve të tjera në adresimin e aktiviteteve ekstremiste të dhunshme dhe terroriste në rrjetet digjitale, është një element që duhet të marrë një vëmendje më të madhe dhe të adresohet në mënyrën e duhur. Mungesa e një mekanizmi referimi të përbashkët ndërinstitutional “*ad hoc*” për vlerësimin e rrezikut të recidivizmit është gjithashtu një sfidë e rëndësishme që duhet të adresohet në të ardhmen. Deri më tani aktivitetet janë ndërtuar mbi forcimin e kapaciteteve dhe përmirësimin e mekanizmave ekzistues për grupet vulnerabël.

Për të arritur sukses në këtë proces, është e rëndësishme që të kemi një qasje të integruar, duke përfshirë të gjitha palët e interesuara, përfshirë qeverinë, organizatat jo-qeveritare dhe komunitetet lokale si dhe përfaqësuesit e komuniteteve fetare të njohura zyrtarisht në Shqipëri. Gjithashtu, duhet të respektohen dhe zbatohen ligjet dhe standardet ndërkombëtare që mbrojnë të drejtat dhe sigurinë e personave të kthyer nga zonat e konfliktit. Kjo do të kontribuojë në ndërtimin e një shoqërie më të qëndrueshme dhe paqësore, në të cilën të gjithë individët kanë mundësinë të jetojnë me dinjitet dhe pa frikë.

Ngritja dhe funksionimi i Komiteteve Rajonale për Parandalimin e Radikalizimit dhe Luftën kundër EDH² përfaqëson një zhvillim të rëndësishëm në drejtim të parandalimit, kundërshtimit dhe luftën kundër këtyre fenomeneve. Kjo njësi që do të veprojë në nivel qarku për zbatimin e mekanizmit kombëtar të referimit pranë Koordinatorit Kombëtar për Parandalimin dhe Kundërshtimin e EDH dhe referimin pranë QKEDH të individëve apo grupeve të radikalizuara ose në rrezik radikalizimi.

Analizë e qasjeve të zbatuara në vendet e rajonit me qëllim identifikimin e praktikave të mira dhe të aspekteve që duhen përmirësuar

Riintegrimi i luftëtarëve të huaj terroristë që janë rikthyer në vendet e tyre të origjinës përfaqëson një ndërhyrje sfiduese për të gjitha vendet e rajonit, pavarësisht nivelit të zhvillimit. Është e rëndësishme të theksohet se riintegrimi i LHT ndikon në nivel individual por dhe në nivel komuniteti dhe për këtë arsye përbën një sfidë për institucionet e përfshira.

Riintegrimi i kësaj kategorie individësh përfshin integrimin social dhe ekonomik të tyre porse edhe aspekte të sigurisë kombëtare dhe ngre dilema etike për institucionet ligjzbatuese në lidhje me respektimin e të drejtave të LHT dhe familjeve të tyre përkundrejt rrezikut që ato paraqesin për shoqërinë.

Pavarësisht se është një kategori pothuaj e vogël në numra, rreziku që ato paraqesin kërkon ndërhyrje efektive dhe të koordinuara, për shkak të rrezikut që paraqesin për radikalizim të mëtejshëm, ndikim në komunitet duke rekrutuar individë të tjerë dhe rritur nivelin e ekstremizmit të dhunshëm ose rrezikut që mund të përdorin aftësitë e tyre për të organizuar veprimtari terroriste.

LHT profilizohen si burra që kanë luftuar e kontribuar në konfliktet e armatosura në vend të huaj. Megjithatë, studimet tregojnë se në shumë raste kanë luajtur rol aktiv edhe gratë dhe të rinjtë madje dhe fëmijë. Këto kategori nuk kanë qenë vetëm viktima apo dëshmitarë.

Në të gjitha vendet e rajonit, të analizuara në këtë dokument, janë adaptuar masa ligjore dhe politika të reja që ti përgjigjeshin më mirë sfidave që lidhen me rehabilitimin e riintegrimin e të kthyerve nga zonat e konfliktit. Po kështu, të gjitha vendeve i është dashur të përshtasin kuadrin institucional në ndihmë të adresimin të çështjeve të rëndësishme të sigurisë dhe garantimit të përshtatshëm të të drejtave të njeriut për LHT, të kthyerit e tjerë dhe individët e prekur nga EDH dhe radikalizimi. Përshtatja e kuadrit institucional ka përfshirë jo vetëm ngritjen e strukturave të reja të dedikuara si QKEDH dhe Koordinatori Kombëtar për Ekstremizmin e Dhunshëm në rastin e Shqipërisë dhe

² Urdhër i Kryeministrit Nr. 185, datë 31.10.2023 “Për ngritjen dhe funksionimin e Komiteteve Rajonale për Parandalimin e Radikalizimit dhe Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm”;

Kosovës por edhe mënyrën e ndërveprimit të institucioneve ekzistuese ligjzbatuese në drejtim të garantimit të sigurisë së vendit dhe ndëshkueshmërisë së rasteve.

Pavarësisht qasjes të fortë policore apo qasjes së butë të ndjekur nga secili vend, e përbashkët për të gjitha vendet është fakti i përfshirjes së masave mbështetëse rehabilituese dhe riintegruese për LHT, të kthyerit e tjerë dhe individët e radikalizuar ose në rrezik. Në këtë kuadër, dokumentet strategjikë të miratuara në të gjithë këto vende, përveç Serbisë që nuk e ka përfunduar ende, kanë përfshirë në mënyrë të shprehur në një shtyllë të veçantë rehabilitimin dhe riintegrimin, që ka qenë një aspekt i munguar në strategjitë e mëparshme. Strategjia aktuale në Serbi nuk reflekton rolin e familjes, komunitetit dhe shoqërisë civile në proceset e rehabilitimit dhe riintegrimin.

Për më shumë, në shumicën e këtyre vendeve janë adaptuar Procedura Standarde Veprimi për të siguruar ndërveprimin efektiv ndërinstitutional dhe ndjekjen e procedurave të përshtatura me veçoritë e nevojat e individëve target i tyre. Pothuaj gjitha praktikrat kanë të përbashkët ngritjen e grupeve multidisiplinare, në përbërje të të cilëve kishte profesionistë të profileve të ndryshme për të adresuar çështjet e shëndetit mendor, ndihmës psikologjike dhe psikosociale të vazhduar, arsimimit e rehabilitimit e riintegrimin social dhe ekonomik.

Në të gjitha vendet, vështirësi ka paraqitur regjistrimi i fëmijëve të lindur në zonat e konfliktit, të cilët kanë udhëtuar dhe janë kthyer në vendet e origjinës së prindit të pashoqëruar me certifikatë lindje. Në rastin e BH këtyre fëmijëve i është dhënë një status i veçantë si “të padukshëm” ndërkohë që legjislacioni që lidhet me përfitimin e shërbimeve e mbështetjes për këta fëmijë është rishikuar për të përfshirë këtë kategori. Sërisht, ky mund të jetë vetëm një status i përkohshëm që i mundëson aksesin në mbështetje të menjëhershme por nuk është një zgjidhje e qëndrueshme. Në Shqipëri gjithashtu u miratuan parashikime për përfitimin e shërbimeve nga fëmijët e kthyer të paregjistruar deri në përfundimin e procedurave të regjistrimit në gjykatë për këta fëmijë.

Një aspekt i rëndësishëm i praktikave të rezultuara si të suksesshme ka qenë ndërveprimi dhe përfshirja e organizatave të shoqërisë civile, komunitetit dhe familjeve të origjinës së të kthyerve në proceset rehabilituese dhe riintegruese të të kthyerve, praktikë e cila nuk është zbatuar vetëm në Serbi. Megjithatë Serbia ka treguar angazhim në adresimin e situatës, sërisht ka përjetuar sfida të mëdha në shtrirjen e programeve të riintegrimin pas daljes nga burgu ose për individët që kishin marrë dënime me kusht.

Qëllimi dhe Objektivat

Ky raport është porositur nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit në kuadër të nismës “Të lemë të kaluarën pas: ndërtojmë rezistencë ndaj ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet mbështetjes dhe edukimit” i financuar nga GCERF dhe zbatuar në bashkëpunim me Linjën e këshillimit për Gra dhe Vajza.

Qëllimi i tij është të identifikojë dhe analizojë kuadrin ligjor dhe nënligjor që lidhet me riintegrimin e LHT, familjarëve të tyre dhe personave të tjerë të radikalizuar ose në rrezik radikalizimi. Për më shumë, ky raport do të përfshijë edhe praktikën institucionale me synim që të analizojë edhe kapacitetet institucionale të institucioneve kryesore me një fokus të veçantë tek institucionet penitenciare.

Objektivi final i kësaj detyre është të pasqyrojë rekomandime në drejtim të përmirësimit të legjislacionit por edhe përmirësimit të kapaciteteve institucionale me qëllim riintegrimin e sigurt, të qëndrueshëm dhe efektiv të LHT, familjarëve të tyre dhe personave të radikalizuar ose në rrezik radikalizimi. Termi i përdorur për LHT në dokumente të tjera si Procedurat Standarde të Veprimit, ka qënë “të kthyerit”, bazuar dhe në VKM Nr.826, datë 26.10.2021 e cila është konfindenciale dhe e papublikuar në Fletoren Zyrtare.

Metodologjia

Bazuar në qëllimin dhe objektivat e kësaj detyre, analiza e kuadrit ligjor dhe institucional u bazua në një metodologji e cila siguron një qasje të strukturuar për të realizuar qëllimin dhe objektivat e analizës.

Metodologjia për realizimin e kësaj analize përfshin punë studimore dhe kërkimore individuale të ekspertit por edhe konsultimin e aktorëve kryesorë institucionalë. Puna individuale kërkimore dhe studimore konsiston para së gjithash në identifikimin e bazës ligjore përkatëse e cila do të analizohet në një qasje që synon të nxjerrë në pah vakume të mundshme ligjore apo nevoja për përmirësim, por edhe me identifikimin dhe studimin e analizave dhe raporteve të mëparshme të realizuara në lidhje me riintegrimin e LHT, familjeve të tyre dhe personave të tjerë të radikalizuar ose në rrezik radikalizimi, të realizuara në kontekstin e vendit tonë ose të vendeve të tjera për të identifikuar praktika të mira.

Identifikimi i akteve ligjore dhe nënligjore që lidhen me rehabilitimin dhe riintegrimin e grupit të synuar nga kjo analizë kontribuon edhe në identifikimin e rrethit të aktorëve kryesorë institucionalë të përfshirë në proceset e rehabilitimit dhe riintegrit. Përveç një analize të përmbledhur të roleve dhe përgjegjësi të tyre kryesore e cila do të bazohet kryesisht në rregullimet ligjore në fuqi, institucione të përzgjedhura do të konsultohen për problematikat që ato kanë ndeshur dhe mënyrat e adresimit të tyre.

Konsultimi i aktorëve institucionalë kryesorë do të realizohet nëpërmjet pyetësorëve të hartuar, të përshtatur për secilin institucion në përputhje me natyrën e përgjegjësi të roleve që ai institucion ka në proceset rehabilituese dhe riintegruese të LHT, familjeve të tyre dhe personave të tjerë të radikalizuar ose në rrezik radikalizimi. Në hartimin e pyetësorëve janë marrë parasysh edhe studime e raporte të mëparshme, të realizuara në vendin tonë, në nivel rajonal ose në vende të tjera, me qëllim që kontributi i mbledhur

nga institucionet nëpërmjet pyetësorëve të shërbejë sa më mirë për vlerësimin e kapaciteteve të tyre institucionale dhe identifikimin e problematikave ose pengesave të hasura, qofshin këto që lidhen me legjislacionin ose kapacitetet e pamjaftueshme në terma të trajnimeve, infrastrukturës, burimeve njerëzore dhe financiare.

Analiza Ligjore

*Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*³ i vendos të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në themel të rendit juridik duke i konsideruar ato si të pandashme, të patjetërsueshme dhe të padhunueshme. Organet publike, në përmbushje të detyrave të tyre dhe në përputhje me fushën e përgjegjësisë duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre. Për më shumë, fëmijët, të rinjtë dhe gratë kanë të drejtën e një mbrojtje të veçantë nga shteti.

Në përmbushje të objektivave sociale dhe brenda kompetencave kushtetuese e mjeteve që disponon, shteti synon punësimin, plotësimin e nevojave për strehim, sigurimin e standardit më të lartë shëndetësor, fizik e mendor të mundshëm, arsimimin dhe kualifikimin e fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve të papunë, përkujdejsë dhe ndihmë për jetimët, riaftësimin shëndetësor si dhe integrimin në shoqëri të individëve të cilët kanë vështirësi për shkak të situatave personale, familjare dhe shëndetësore.

Në procesin e rehabilitimit dhe ri-integrimit të të kthyerve nga zonat e konfliktit, e veçanërisht LHT, personave të radikalizuar ose në rrezik radikalizimi, fokusi në çështjet e sigurisë dhe ato të riintegritimit të tyre socio-ekonomik është i të njëjtës vlerë nga pikëpamja e zbatimit të ligjit por çështjet e sigurisë marrin përparësi në kuadër të detyrimit kushtetues për garantimin e sigurisë së vendit dhe ruajtjen e interesave kombëtare. Kushtetuta e RSH parashikon që kufizimet në të drejtat dhe liritë mund të vendosen vetëm për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe mbrojtja e sigurisë së vendit legjitimon vendosjen e kufizimeve duke qenë se lidhet me dhe një interes të lartë publik dhe me garantimin e të drejtave të të tjerëve. Gjithsesi, në përputhje me nenin 17 pika 2 të Kushtetutës kufizimet e vendosura nuk mund të çenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara nga neni 18 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Riintegrimi i LHT ose individëve të tjerë të radikalizuar ose në rrezik radikalizimi është një proces kompleks dhe i shtrirë në kohë që ka për qëllim riintegrimin e këtyre individëve në shoqëri në mënyrë të qëndrueshme. Të gjitha përpjekjet dhe programet riintegruese kanë një synim të spikatur në shkëputjen përfundimtare të këtyre individëve nga veprimtaritë terroriste dhe radikalizimi me qëllim uljen e mundësisë së ripërfshirjes së tyre.

³ Ligji Nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Faktorët shytës dhe nxitës që kanë ndikuar LHT të udhëtojnë në zonat e konfliktit janë të ndryshëm dhe po kaq e ndryshme kanë qenë dhe mënyrat se si këta individë janë përshtatur dhe kanë shërbyer në zonat e konfliktit duke u përgatitur dhe fituar aftësi të cilat përbëjnë rrezik serioz në rastet e kthimit të tyre në vendet e origjinës. Ndaj të gjitha praktikrat rajonale dhe ndërkombëtare, pavarësisht qëndrimeve të forta, të buta ose mikse që kanë mbajtur, sugjerojnë se proceset riintegruese për këtë kategori duhet të bazohen në një qasje holistike që synon e siguron mbrojtje të përshtatshme drejt rehabilitimit dhe riintegrit të LHT, familjeve të tyre dhe individëve të radikalizuar ose në rrezik në kuadër të përpjekjeve të vazhduara për të parandaluar dhe kundërshtuar fenomenet e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

*Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZhIE)*⁴ e cila është dokumenti obrellë për hartimin e politikave sektoriale, vlerëson se Shqipëria ka bërë progres në masat parandaluese kundër terrorizmit, radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet zhvillimit të politikave efektive në këtë fushë dhe rritjes së kapaciteteve të agjencive ligjzbatuese. Këto politika janë zhvilluar mbi 4 shtylla kryesore që lidhen me sinjalizimin e hershëm, parandalimin, mbrojtjen dhe reagimin. Ato reflektojnë vlerësimet dhe analizat e situatës në vendin tonë dhe janë përqasur me dokumentet strategjike të BE si Strategjia e Sigurisë së BE dhe Agjenda e BE për luftën kundër terrorizmit si edhe Direktivën e BE 2017/541 për luftën kundër terrorizmit.

Ky dokument vlerëson se situata aktuale në vendin tonë, lidhur me kërcënimet terrorizmit është në nivel të ulët, gjë që tregon reagim të kënaqshëm ndaj fenomeneve të tilla. Kjo i atribuohet edhe bashkëpunimit të strukturave të antiterrorit me strukturat homologe të vendeve të tjera. Sidoqoftë, strategjia thekson që është e rëndësishme të sigurohet një vëmendje e shtuar në çdo kohë, nëpërmjet zhvillimit dhe zbatimit të programeve të ndryshme dhe metodave parandaluese. Kjo përfshin ndërmarrjen e iniciativave që synojnë të parandalojnë ekstremizmin dhe të krijojnë një sistem efektiv dhe të qëndrueshëm për monitorimin dhe sinjalizimin në kohë të aktiviteteve të ndërlidhura me ekstremizmin e dhunshëm që mund të çojnë në veprimtari terroriste.

Kundërshtimi i fenomeneve të radikalizimit, ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit ka zënë një vend të rëndësishëm në SKZhIE si nga pikëpamja e sigurisë kombëtare dhe e mbrojtjes së vendit. Rritja e parametrave të sigurisë në komunitet është një qëllim i rëndësishëm i politikës i përfshirë në këtë dokument dhe për këtë janë dhënë orientime për forcimin e rolit të Njësitë të Vetëqeverisjes Vendore nëpërmjet Koordinatorit Vendor, NjMF e GTN si edhe Këshillave Vendore të Sigurisë Publike. Ndërgjegjësimi i nxënësve në institucionet arsimore dhe kundërshtimi e identifikimi i hershëm i këtyre fenomeneve

⁴ VKM Nr. 88, datë 22.02.2023 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030”;

në shkolla është vlerësuar si një masë e rëndësishme me impakt të qëndrueshëm në rritjen e reagimit e rezistencës së komunitetit.

Bazuar në orientimet strategjike të SKZhIE, në vitin 2023 u miratua *Strategjia e re Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023-2025*⁵. Megjithëse në 2015 ishte miratuar një strategji kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe kjo strategji nuk kishte një datë të përfundimit të vlefshmërisë së saj, ishte e nevojshme azhurnimi i kuadrit të politikave për të adresuar format e reja të shfaqjes së këtyre fenomeneve dhe reflektuar qasjet ndërkombëtare dhe praktikrat e mira për adresimin gjithëpërfshirës dhe efektiv të tyre. Ky dokument strategjik parashikon qasje dhe objektiva që lidhen me parandalimin e këtyre fenomeneve, përgjigjen ndaj formave të reja që këto fenomene kanë marrë sidomos në mjedisin digjital por edhe në lidhje me reagimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e personave të prekur nga këto fenomene ose në rrezik për t'u prekur, qasje të cilat mungonin në strategjinë e mëparshme.

Ky dokument politikash, i cili është më i rëndësishmi në këtë fushë, i kushton një rëndësi të shtuar parandalimit të EDh dhe terrorizmit dhe identifikimit të hershëm grupeve, individëve dhe metodave radikale. Qëllimi final është sigurimi i rendit dhe sigurisë publike dhe mbajtja e kërcënimit terrorist në nivel të ulët. Për arritjen e këtyre objektivave strategjike janë parashikuar ndërhyrje që lidhen me rritjen e kapaciteteve të agjencive inteligjente dhe institucioneve ligjzbatuese në drejtim të parandalimit, ndërprerjes së financimit të terrorizmit, vlerësimeve të riskut, analizave dhe kërkimeve për faktorët nxitës e shtytës dhe format e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit. Masa të caktuara synojnë rritjen e efektshmërisë së bashkëpunimit ndërinstitutional në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Përmirësimi i sistemeve të mbledhjes, ruajtjes, analizimit dhe shpërndarjes së informacionit është vlerësuar si një ndërhyrje e rëndësishme për sigurimin e mbajtjen në mënyrë të sigurt të informacionit, analizimin e tij dhe ndërveprimin efektiv me agjenci e institucione të tjera ligjzbatuese, brenda e jashtë vendit.

Për shkak të përdorimit më të shtuar të mjedisit digjital për nxitjen e këtyre fenomeneve dhe rekrutimin e radikalizimit të individëve, janë parashikuar ndërhyrje për një prezencë të strukturave të antiterrorit në mjedisin virtual, përmes kontrollit dhe monitorimit të hapësirave virtuale duke përfshirë *darknet*. Zhvillimi i një komunikimi strategjik nëpërmjet rritjes së njohurive dhe ndërgjegjësimit të komuniteteve për këto fenomene me qëllim rritjen e reagimit dhe rezistencës së tyre përfaqëson një element të rëndësishëm dhe me impakt të qëndrueshëm në parandalimin dhe kundërshtimin e fenomeneve të radikalizimit, Edh dhe terrorizmit.

⁵ VKM Nr. 81, datë 14.02.2023 "Për miratimin e Strategjisë Sektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023-2025 dhe të Planeve të Veprimit 2023-2025";

Një risi e kësaj strategjie është përfshirja e qëllimit të politikës për rehabilitimin, riintegrimin, risocializimin dhe deradikalizimin e individëve të radikalizuar, në rrezik radikalizimi dhe të kthyerve nga zonat e konfliktit. Rritja e kapaciteteve të institucioneve të përfshira në proceset rehabilituese dhe riintegruese për këto kategori personash synon menaxhimin e dhënies së ndihmës së viktimave të terrorizmit, fuqizimin ekonomik, rritjen e aksesit në programet e strehimit social. Për përmbushjen e këtyre objektivave janë parashikuar veprimtari për rritjen e kapaciteteve të institucioneve të përfshira dhe hartimi i procedurave standarde të veprimit për fuqizimin e komuniteteve dhe riintegrimin e rehabilitimin e të kthyerve.

*Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë*⁶ është një instrument ligjor themelor për mbrojtjen e rendit të ligjit dhe sigurisë në shoqëri. Duke qenë se aktualisht, Kodi Penal është nën një proces të gjerë rishikimi me qëllim hartimin e një Kodi të ri, kjo analizë nuk do të shkojë thellë në parashikimet aktuale të Kodi Penal për veprat penale të lidhura me ekstremizmin, radikalizmin dhe kërcënimet terroriste por paraqet në kontekst historik ndryshimet që ky kod ka pësuar për të adresuar fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit.

Kodi Penal, ka përcaktuar kategoritë e veprave penale që lidhen me ekstremizmin, radikalizmin dhe terrorizmin si edhe dënimet penale përkatëse. Përmes ndryshimeve që i janë bërë Kodit Penal konkretisht në vitin 2012⁷ dhe 2014⁸, ai është përmirësuar për të adresuar sfidat e reja të shoqërisë në lidhje me fenomenin e terrorizmit dhe pjesëmarrjes në veprime luftarake në një shtet të huaj. Disa prej dispozitave kyçe janë ato që përcaktojnë organizatat terroriste dhe parashikojnë veprat penale të kryera me qëllime terroriste, të cilat janë të përfshira në Kreun VII të Kodit Penal. Përveç kësaj, nenet 265/a, 265/b dhe 265/c rregullojnë klasifikimin e veprave që lidhen me nxitjen, rekrutimin, organizimin, drejtimin, stërvitjen, vënien në dispozicion të pajisjeve, financimin e veprimeve luftarake në një shtet të huaj dhe dënimet penale përkatëse. Përmes këtyre ndryshimeve të Kodi Penal, Shqipëria është përpjekur për të adresuar me sukses kërcënimet e ekstremizmit dhe radikalizmit, duke forcuar sistemin e drejtësisë për të trajtuar këto sfida të sigurisë. Ndërkaq, rishikimi aktual i Kodi Penal tregon një përpjekje të vazhdueshme për të përshtatur ligjin me kohën dhe për të përmirësuar mbrojtjen e shoqërisë nga ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizmi. Gjithsesi ka ende aspekte të munguara në kategorinë e veprimeve që përbëjnë vepër penale siç është veprimtaria digjitale me përmbajtje ekstremiste dhe terroriste. Rishikimi tërësor i Kodit Penal krijon

⁶ Ligji nr. 7895, datë 27 janar 1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar <https://qbz.gov.al/eli/ligj/1995/01/27/7895/49876337-8143-4c8e-bba8-a8620022f231>

⁷ Ligji Nr. 23/2012 “Për disa shtesa e ndryshime ne Ligjin Nr. 7895, datë 27 janar 1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”;

⁸ Ligji Nr. 98, datë 31.07.2014 “Për disa shtesa e ndryshime ne Ligjin Nr. 7895, datë 27 janar 1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”;

mundësinë më të mirë për kategorizimin dhe sanksionimin e duhur të fenomeneve të radikalizimit, EDh dhe terrorizmit.

Nga ana tjetër, *Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur*⁹, përmban rregullime të posaçme për përgjegjësinë penale të të miturve, rregullat proceduriale për gjithë zinxhirin e hetimit e dënimit, përfshirë rehabilitimin ose çdo masë tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitar të një veprë penale, duke përfshirë dhe të rinjtë deri në 21 vjeç. Fëmijë e të mitur kanë qenë jo vetëm dëshmitarë e viktima të ndikimit të LHT ose veprimeve luftarake në shtet të huaj por në disa raste kanë qenë dhe pjesëmarrës aktivë. Qëllimi i kodit të drejtësisë për të mitur është të promovojë riintegrimin e të miturve në konflikt me ligjin, të garantojë risocializimin dhe rehabilitimin e tyre dhe të parandalojë recidivizmin. Me këtë synim, ky kod parashikon masa specifike dhe të detajuara për trajtimin e të miturve përgjatë procesit penal dhe procedimit për veprat penale të parashikuara nga Kodi Penal.

Në zbatim të vendimeve penale për të cilat parashikohet masa sigurisë ose dënimit me burgim, *ligji për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*¹⁰ përcakton të drejtat dhe mënyrën e trajtimit të paraburgosurve dhe dënuarve me burgim duke siguruar respektimin e të drejtave dhe lirive themelore si dhe trajtimin e tyre me dinjitet. Trajtimi i të burgosurve, bazohet në një plan individual trajtimi që reflekton vlerësimin dhe nevojat specifike të tyre. Qëllimi final i trajtimit është rehabilitimi social dhe riintegrimi i kësaj kategorie. Mjediset e institucioneve penitenciare janë veçanërisht të ekspozuara ndaj përhapjes së fenomeneve të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Ky ligj parashikon regjim të posaçëm në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së lartë për të paraburgosurit dhe të dënuarit që hetohen ose gjykohen për veprat penale me qëllime terroriste dhe veprat që lidhen me pjesëmarrjen dhe organizimin për pjesëmarrje në veprime luftarake në një shtet të huaj. Regjimi i posaçëm mund të zbatohet edhe ndaj të burgosurve që pavarësisht veprës penale që kanë konsumuar, paraqesin rrezikshmëri për shkak të lidhjeve me organizata terroriste. Vendosja në kufizimet e regjimit të posaçëm përlligjet nga qëllimi i ruajtjes së rendit dhe sigurisë. Një rol të rëndësishëm për sigurimin e ushtrimit të të drejtave të të dënuarve por edhe menaxhimin e rasteve që paraqesin rrezikshmëri më të lartë, luan Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve. Të dënuarve i sigurohen shërbime të kujdesit shëndetësor përfshirë kontrollet për shëndetin mendor dhe çrregullimet posttraumatike. Të burgosurit kanë të drejtë të punojnë në përputhje me gjendjen shëndetësore, njohuritë dhe aftësitë dhe shpërblehen për punën e tyre, duke ju njohur dhe si periudhë vjetërsie në punë. Atyre i sigurohet akses në programe arsimit dhe formimi profesional dhe përfshihen në veprimtari kulturore e sportive. Të burgosurit

⁹ Ligji Nr. 37/2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur";

¹⁰ Ligji Nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve";

gëzojnë dhe të drejtën e besimit dhe ushtrimit të riteve fetare dhe për këtë institucioni penitenciar i siguron mjedise të veçanta për praktikimin e fesë dhe aksesin e literaturës fetare.¹¹ Ky ligj parashikon dhe shkeljet dhe masat disiplinore për veprimet e të burgosurve. Konsiderohen si shkelje shumë të rënda disiplinore, organizimi, pjesëmarrja dhe nxitja e veprimtarive që çënojnë masat e sigurisë në burgje. Përgjegjësia e institucioneve penitenciare shtrihet edhe në përgatitjen e lirit të të burgosurve dhe ndërveprimin me strukturat e tjera për të mbështetur riintegrimin e tyre në shoqëri edhe pse deri tani referohet që nuk është menaxhuar ndonjë rast që i përket kësaj kategorie.

Për sa i përket rehabilitimit dhe riintegrit në shoqëri të individëve, subjekt i vendimeve gjyqësore penale, *ligji për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës*¹² ka për qëllim rehabilitimin e riintegritin e këtyre individëve nën mbikqyrje, parandalimin e recedivizmit ose kryerjes së veprave të tjera penale nëpërmjet përfshirjes shoqërore dhe zhvillimit të ndjenjës së përgjegjësisë ndaj shoqërisë. Shërbimi i provës ka funksione të rëndësishme jo vetëm për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative dhe vlerësimin e veprimtarisë së personave nën mbikqyrje por edhe adreson problematikat për punësim, strehim, arsimim, kualifikime dhe nevojat për mbrojtje sociale të këtyre individëve.

*Ligji për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës*¹³ përfaqëson gjithashtu një pjesë të rëndësishme të legjislacionit që duhet të analizohet nga pikëpamja e rehabilitimit dhe riintegritit të fëmijëve të kthyer nga zonat e konfliktit, familjarë të LHT, ose fëmijëve të prekur nga fenomenet e EDh dhe radikalizimit apo në rrezik. Legjislacioni për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës përfaqëson një kuadër ligjor të plotë dhe efektiv në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve deri në 18 vjeç, garantimin e mirëqenies dhe përmirësimit të cilësisë së jetës nëpërmjet sistemit të integruar të mbrojtjes. Në çdo rast, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsideratë parësore që udhëheq punën e profesionistëve në procesin e rehabilitimit dhe riintegritit të fëmijëve të kthyerve të cilët në kuptim të ligjit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe ligjit për shërbimet e kujdesit shoqëror, konsiderohen si fëmijë në nevojë për mbrojtje të veçantë.

Në përputhje me rregullimet e legjislacionit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, gjatë procesit të rehabilitimit dhe riintegritit, fëmijës duhet t'i sigurohen standardet më të larta të shëndetit, trajtimit, rehabilitimit dhe riintegritit dhe t'i ofrohet shërbim i personalizuar dhe specializuar. Në rastin e fëmijëve të kthyer duhet t'i garantohet

¹¹ Ky bashkëpunim rezulton i përforcuar nëpërmjet një Marrëveshje bashkëpunimi midis Strukturave të Antiterrorit në Policinë e Shtetit, Drejtorisë së Burgjeve si dhe Komitetit Musliman Shqiptar me fokus të veçantë përzgjedhjen e literaturës si dhe ofrimit të shërbimeve fetare që imamë të autorizuar mund të kryejnë në ambientet e IEVP-ve.

¹² Ligji Nr. 78/2020 "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës";

¹³ Ligji Nr. 18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës";

stabilitet dhe vazhdimësi në kujdes shëndetësor, mbrojtje, rritje e edukim, duke mbajtur parasysh formimin e tyre fetar kulturor dhe gjuhësor.

Në kthimet e mëparshme ka patur dhe raste të fëmijëve të lindur në zonat e konfliktit, me të paktën një prind shqiptar. Edhe në rastet e fëmijëve pa shtetësi, në përputhje me legjislacionin në fuqi, fëmija është bartës i të gjithë të drejtave që lidhen me mbrojtjen, zhvillimin dhe mirëqenien. Fëmijës së kthyer i garantohet e drejta për të pasur një shtetësi, për të ruajtur identitetin dhe e drejta e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë.

Respektimi i privatësisë së fëmijës është i rëndësishëm në çdo fazë të rehabilitimit dhe riintegrit të fëmijës së kthyer dhe cënimi i kësaj të drejte të fëmijës ndikon në mënyrë negative në ecurinë e këtyre proceseve. Transmetuesit audiovizivë mbajnë përgjegjësi për rastet e mosrespektimit të kësaj të drejte të fëmijës në procesin e raportimit në media të fenomenit apo rastit të fëmijëve të prekur nga fenomenet e EDh dhe radikalizimit apo fëmijëve të kthyer nga zonat e konfliktit, në përputhje me ligjin për të drejtat e mbrojtjen e fëmijës dhe legjislacionin për mediat audiovizuale. Përdorimi i imazheve të të miturve të kthyer nga mediat, ka sjellë dëme të mëdha. Në këtë drejtim edhe ASHDMF ka përgjegjësi për të marrë masa sipas kompetencave që i cakton kuadri ligjor kombëtar.

Përveç legjislacionit të mësipërm, ligje të tjera që lidhen me aspekte të rehabilitimit, risocializimit dhe riintegrit të LHT dhe personave të tjerë të radikalizuar ose në rrezik radikalizimi rregullojnë forma të mbrojtjes dhe mbështetjes nga shteti për kategoritë vulnerabël dhe institucionet përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve mbështetëse dhe integruese. Në përputhje me *ligjin për vetëqeverisjen vendore*¹⁴, bashkitë janë përgjegjëse për krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale në nivel vendor për kategoritë vulnerabël dhe sipas mënyrës së përcaktuar në ligjet përkatëse. Në kuadër të funksioneve të bashkive në fushën e sigurisë publike, ato janë përgjegjëse garantimin e mbarëvajtjes së marrëdhënieve në komunitet, parandalimin dhe ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve. Në këtë drejtim, promovimi i rolit të KVSP-ve në nivel vendor ka kontribuar për marrjen e përgjegjësisë në formë të koordinuar nga institucionet e pushtetit vendor me qëllim zgjidhjen e tyre në një qasje të integruar.

Nga ana tjetër, ligje specifike sigurojnë ririntegrimin e individëve nëpërmjet aksesit në arsim, arsim e formim profesional dhe punësim. Kështu në përputhje me ligjin *për sistemin arsimor parauniversitar*¹⁵ e drejta për arsim i garantohet pa diskriminim të gjithë shtetasve shqiptarë, të huaj dhe pa shtetësi. Në përmbushje të kësaj të drejte, ministri i arsimit ka miratuar një udhëzim¹⁶ për regjistrimin dhe mbështetjen në institucionet

¹⁴ Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";

¹⁵ Ligji Nr. 69/2012 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;

¹⁶ Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 10, datë 17.05.2021 "Për regjistrimin dhe mbështetjen në institucionet arsimore parauniversitare publike të fëmijëve të personave në situatë

arsimore parauniversitare publike të fëmijëve që kthehen nga zonat e konfliktit. Ky udhëzim rregullon në mënyrë specifike mënyrën e pranimi dhe regjistrimit në shkolla të këtyre fëmijëve në bazë të vlerësimeve të nevojave arsimore dhe nevojave psiko-sociale të këtyre fëmijëve, duke tejkaluar edhe mangësi të mundshme në dokumentacion.

Mundësi të tjera në ndihmë të riintegrit social dhe ekonomik të individëve në situata vulnerabiliteti nën të cilat klasifikohen dhe LHT dhe familjet e tyre si dhe individët e tjerë të radikalizuar ose në rrezik radikalizimi ofrohen nga legjislacioni për shërbimet e kujdesit shoqëror, legjislacioni për nxitjen e punësimit e legjislacioni për ndërmarrjet sociale. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi siguron mbrojtjen nga diskriminimi dhe aksesin e pacënuar nga faktorët diskriminues në këto shërbime.

Kuadri Institucional

Praktikat e mira ndërkombëtare sugjerojnë që proceset rehabilituese, risocializuese dhe riintegruese duhet të bazohen në qasjen mbarëshoqërore (*whole society approach*) që realizohet me angazhimin e shumë aktorëve publikë dhe jopublikë, përfshirë organizatat e shoqërisë civile, anëtarët e komunitetit dhe familjen. Ngritja e sistemit të trajtimit të rasteve të të kthyerve nga zonat e konfliktit, e mbështetur në mënyrë gjithëpërfshirëse nga ana e organizatës Terre des hommes, është cilësuar si një praktikë pozitive si në drejtim të ofrimit të vazhduar të mbështetjes por edhe në drejtim të realizimit të një ndërveprimi efektiv ndërmjet aktorëve publikë e jopublikë.

Megjithatë është përgjegjësia e shtetit që të administrojë çështjet e sigurisë dhe të të drejtave të njeriut për LHT, familjet e tyre që janë kthyer nga zonat e konfliktit dhe individët e tjerë të radikalizuar ose në rrezik radikalizimi në mënyrë gjithëpërfshirëse, efektive, të koordinuar dhe në bashkëpunim me aktorë jopublikë.

Megjithëse fenomenet e ekstremizmit dhe radikalizimit nuk janë fenomene të reja, përpjekjet parandaluese dhe kundërshtuese të shteteve ndaj tyre janë në vlerësim, rishikim dhe evoluim të vazhduar. Fenomene të tilla karakterizohen nga faktorë kompleksë që janë të vështira për t'u kuptuar në mënyrë gjithëpërfshirëse para së gjithash e më pas për t'u adresuar në mënyrën e duhur me qëllim uljen e mundësisë për recidivizëm.

Agjencitë inteligjente dhe ligjzbatuese me një rol të rëndësishëm në parandalimin e kundërshtimit të ekstremizmit të dhunshëm, radikalizimit dhe terrorizmit përfshijnë një rreth të gjerë aktorësh publikë. *Drejtoria e Antiterrorit në Drejtorinë e Policisë së Shtetit* është organi kryesor në luftën kundër terrorizmit. Kohët e fundit vihet re një rritje e nivelit të

migrimi/azili, refugjatë, të fëmijëve të huaj të pashoqëruar, të fëmijëve që kthehen nga emigracioni, nga zonat e konfliktit apo fëmijë viktime të trafikimit në Republikën e Shqipërisë”;

besimit të qytetarëve tek Policia e Shtetit. Agjenci të tjera aktive në këtë fushë janë *Shërbimi Informativ Shtetëror dhe Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes*.

Edhe personeli i *policimit në komunitet* që është pjesë e policisë së shtetit është i përfshirë në parandalimin dhe luftimin e radikalizimit që çon në ekstremizëm të dhunshëm dhe terrorizëm. Për shkak të rrezikshmërisë së lartë, juridiksioni për të gjitha veprat terroriste, në formë të organizuar dhe jo vetëm, është përqëndruar në nivelin e Zyrës së Prokurorisë Speciale SPAK dhe Gjykatave Speciale, që prej qershor të vitit 2021. Në funksion të strukturave antiterror është krijuar *Njësia për Verifikimin e Terrorizmit dhe Sigurinë*, e cila shërben për shkëmbimin e informacioneve me Qendrën Ndërkombëtare Kundër Terrorizmit dhe me Qendrën Evropiane Kundër Terrorizmit në Europol, për verifikimin e shtetasve shqiptarë dhe të huaj të përfshirë/lidhur në veprimtari terroriste, si dhe njësia për Hetimin e Financimit të Terrorizmit, bazuar kjo edhe në rekomandimet e bëra nga MONEYVAL.

*Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH)*¹⁷ është krijuar që në vitin 2017 si një institucion në varësi të Kryeministrit dhe funksionon në varësi të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike prej tetorit të vitit 2022.¹⁸ QKEDH, është ngarkuar me ngritjen e kapaciteteve, koordinimin e aktiviteteve për parandalimin dhe kundërshtimin e Edh ndërmjet institucioneve shtetërore dhe mbikëqyrjen e zbatimit të strategjisë kombëtare kundër ekstremizmit të dhunshëm. Misioni i saj është të mbrojë shoqërinë nga ekstremizmi i dhunshëm nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve të aktorëve të ndryshëm të përfshirë në veprimet kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe promovimit të vlerave të tolerancës, demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Kompetencat e këtij institucioni janë të lidhura me riintegrimin e LHT dhe familjeve të tyre si edhe koordinimin, në nivel kombëtar dhe lokal, të ndërhyrjeve në komunitetet e prekura nga radikalizimi dhe ekstremizmi i dhunshëm.

Në Shqipëri është ngritur në vitin 2017 *Qendra e Ekselencës së NATO-s për studimin e fenomenit të luftëtarëve të huaj*¹⁹. Misioni i kësaj qendre është të ofrojë kontribut të natyrës studimore dhe edukuese dhe të informojë institucionet vendimmarrëse dhe ligjzbatuese si edhe punonjësit e tyre në lidhje me njohjen, parandalimin e reduktimin e këtij fenomeni duke sjellë dhe përvojat e vendeve të tjera partnere me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi.

¹⁷ VKM Nr.737 Dt. 13.12.2017 “Për Ngritjen e Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH)”

¹⁸ VKM Nr. 604, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e Fushës Së Përgjegjësisë Shtetërore të Ministrisë së Brendshme”;

¹⁹ VKM Nr. 58, datë 03.02.2017 “Për ngritjen, në Shqipëri, të Qendrës së Ekselencës së NATO-s për Studimin e Fenomenit të Luftëtarëve të Huaj”;

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, bashkë me Institucionin e Shërbimit të Provës të cilat veprojnë nën varësinë e Ministrisë së Drejtësisë, luajnë një rol të rëndësishëm në parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit në shoqërinë tonë. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka detyrën e përcaktimit dhe implementimit të politikave dhe strategjive që ndikojnë në menaxhimin e mbikëqyrjen e të burgosurve të dënuarve për vepra penale për qëllime terroriste. Duke njohur rëndësinë e parandalimit të EDh në burgje dhe ndikimin që këto ambiente mund të kenë në procesin e radikalizimit, këto institucione janë përgjegjëse për krijimin e programeve dhe strategjive për parandalimin dhe kundërshtimin e shfaqjes së ekstremizmit të dhunshëm brenda sistemit të dënimit.

Po kështu dhe *Institucioni i Shërbimit të Provës*, është organi shtetëror që paraqet informacion para autoriteteve gjyqësore, mbikëqyr ekzekutimin e dënimit alternativ dhe ndihmon personin e dënuar në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin social duke ndjekur edhe planet e trajtimit individuale të hartuara enkas për këtë qëllim pas një ekspertize të detajuar gjithëpërfshirëse socio-ekonomike dhe psikologjike duke parashikuar edhe elementet e rrezikut të lidhura me sigurinë.

Për të siguruar ri-integrimin e tyre në shoqëri në mënyrë të qëndrueshme, është e rëndësishme që këto institucione të implementojnë programe të specializuara për të adresuar çështjet e radikalizimit dhe ekstremizmit në komunitetin e të dënuarve. Duke vepruar me përgjegjësi dhe në bashkëpunim me autoritetet e tjera, këto institucione mund të ndihmojnë në parandalimin dhe kundërshtimin e përhapjes së EDh në shoqëri.

Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore/Bashkitë luajnë një rol kritik në adresimin dhe parandalimin e fenomeneve të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit. Këto njësi janë në pozicion të mirë për të njohur dhe adresuar faktorët që nxisin dhe shtyjnë të rinjtë drejt ekstremizmit, si dhe për të ndihmuar në rehabilitimin dhe riintegrimin e individëve të prekur.

Njësinë e Vetëqeverisjes Vendore dhe NJMF, që janë pjesë e tyre, kanë rol kryesor në ndërveprimet e parandalimit të EDh në komunitetet e tyre. Ata janë më të afër nevojave dhe problemeve të komunitetit dhe kanë aftësinë për të zhvilluar programe dhe iniciativa të ndryshme që ndihmojnë në parandalimin e EDh.

Gjithashtu, këto njësi mund të luajnë një rol thelbësor në rehabilitimin dhe riintegrimin e individëve të prekur nga ekstremizmi. Ata mund të ofrojnë mbështetje psikosociale, ngritje kapacitetesh, trajnime, zgjidhje problematikash arsimore dhe shërbime tjera që ndihmojnë riintegrimin në shoqëri të kësaj kategorie dhe të jenë pjesë aktive të saj.

Për këtë arsye, promovimi i bashkëpunimit midis Njërive të Vetëqeverisjes Vendore/Bashkive, institucioneve të tjera të qeverisjes, organizatave civile si dhe

komuniteteve fetare të autorizuar është thelbësor për një përgjigje efektive ndaj EDH dhe radikalizimit në nivelet lokale dhe rajonale.

Analiza e kapaciteteve institucionale

Kjo analizë bazohet në përgjigjet e mbledhura nga aktorët kryesorë institucionalë, në nivel qendror dhe lokal, në lidhje me angazhimin e tyre në luftën kundër EDH dhe terrorizmit si dhe me sfidat që ata hasin në lidhje me procesin e intergrimit të LHT dhe familjeve të tyre. Ky segment paraqet një pjesë të rëndësishme të këtij studimi dhe ka për qëllim të hedhë dritë mbi perceptimet dhe rolin e këtyre aktorëve në sfidën komplekse të EDH dhe terrorizmit. Synimi kryesor i kësaj analize është të identifikojë dhe analizojë, qëndrimet, shqetësimet dhe veprimet e aktorëve kryesorë institucionalë në lidhje me sfidën e EDH dhe terrorizmit.

Përmes analizës së rezultateve të pyetësorëve, synohet të nxirret në pah se si këta aktorë e shohin këtë sfidë, se si e perceptojnë rrezikun, dhe se sa janë të përfshirë në përpjekjet për ta adresuar. Kjo analizë ka për qëllim të ofrojë një kontribut të rëndësishëm në njohjen më të mirë të përgjegjësisë dhe efikasitetit të institucioneve në përbërjen e kësaj sfide kritike për sigurinë globale dhe shoqërinë në tërësi.

Qendra Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH)

Pjesë e këtij studimi është padyshim Qendra Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH) si një aktor kyç në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri dhe në rajon. Një nga pyetjet që ju drejtua QKEDH ishte *nëse ka përmirësim të situatës për parandalimin dhe kundërshtimin e radikalizmit dhe EDH në Shqipëri*. Përgjigjja e QKEDH është një pasqyrë e angazhimit tërësor të këtij institucioni për të adresuar këtë sfidë të ndërlikuar. Situata e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në Shqipëri është paraqitur si një çështje komplekse që ndikon në shumë aspekte të shoqërisë dhe politikës. Për të përmirësuar këtë situatë, QKEDH ka ndërmarrë masa në nivel qendror dhe lokal që përfshijnë edukimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve për të identifikuar dhe kundërshtuar ndikimet ekstremiste, përmes trajnimeve dhe fushatave informuese që synojnë të rrisin ndërgjegjësimin dhe të krijojnë mjedise ku të mund të diskutohet hapur për temat e ndryshme.

Gjithashtu, QKEDH thekson rolin e dialogut ndërfaqetor në forcimin e bashkëpunimit dhe dialogut mes komuniteteve fetare për të parandaluar manipulimin e besimeve fetare për qëllime ekstremiste. Një komponent tjetër i strategjisë së QKEDH është trajtimi dhe ndihma për individët e radikalizuar ose të prekur nga ekstremizmi, përfshirë ndihmën psikologjike, trajnimet profesionale dhe përkrahjen sociale për të rikthyer këta individë në shoqëri dhe adresuar situatat e përziera me krim dhe marginalizim shoqëror. Në të

njëjtën kohë, përmes programeve të punës, kujdesen për zhvillimin ekonomik dhe social për të përmirësuar kushtet e jetesës dhe për të zvogëluar ndjenjat e përjashtimit dhe pakënaqësisë që ndikojnë në radikalizëm të personave apo familjeve të prekura nga radikalizmi.

QKEDH gjithashtu informon se ka një përfshirje të autoriteteve të sigurisë dhe agjencive të inteligjencës për të identifikuar, monitoruar dhe ndërhyrë ndaj individëve të radikalizuar dhe grupeve ekstremiste. Përmes bashkëpunimit ndërkombëtar, Shqipëria ka arritur të përfitojë nga përvojat dhe strategjitë e vendeve të tjera për të luftuar ekstremizmin të dhunshëm.

Në përfundim, QKEDH është angazhuar në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm në Luftën kundër Terrorizmit 2023-2025. Ajo vazhdon përpjekjet për të përforcuar qëndresën në komunitet dhe për të zvogëluar tërheqjen ndaj radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, përmes aktiviteteve ndërgjegjëse të opinionit publik dhe rritjes së kapaciteteve, duke përfshirë edhe sektorët shtetërorë dhe aktorët tjerë relevantë të shoqërisë. Gjithashtu, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, po punon për ndërtimin e një database për monitorimin dhe menaxhimin e rasteve, duke përdorur politikën e "Exit/Continue" për të burgosurit që vuajnë dënimin për vepra penale të terrorizmit dhe ekstremizmit. Kjo analizë jep një pasqyrë të plotë dhe të thellë të përpjekjeve të vendit për të luftuar ekstremizmin të dhunshëm dhe për të ri-integruar individët në shoqëri.

Pyetjes se çfarë duhet të arrihet më shumë në fushën kundër EDH që mund të çojë në terrorizëm, QKEDH i përgjigjet duke ofruar një gamë të gjerë rekomandimesh për të përballuar sfidat e radikalizmit dhe për të parandaluar situata që mund të çojnë në EDH dhe radikalizim.

Një nga rekomandimet kryesore është rritja e kapaciteteve profesionale për të menaxhuar kthimin e individëve nga zonat e konfliktit duke synuar të sigurojnë një mjedis të përshtatshëm për kthyerit, përfshirë gratë, vajzat dhe femijët, dhe është një përpjekje e rëndësishme për të ndihmuar këta individë të ndryshojnë rrugëtimin e tyre.

Ndërhyrja në kurrikulën bazë arsimore është një tjetër hapat kyç për të ndikuar në formimin e mendësisë së rinjve dhe për të promovuar vlera të ndryshme të shoqërisë. Për më tepër, përdorimi i një qasjeje shumëdimensionale për të luftuar ekstremizmin përfshin zbatimin e ligjeve dhe strategjive, bashkëpunimin e të gjithë aktorëve relevante dhe krijimin e një mjedisi të përbashkët luftarak kundër radikalizmit.

Tjetër rekomandim është trajnimi i personelit të sistemit të burgjeve për të njohur shenjat e hershme të radikalizimit, rreziqet që kjo sjell për shoqërinë dhe për të parandaluar këtë fenomen brenda institucioneve penitenciare. Programe si HELP, që synojnë të kontribuojnë në sigurinë rajonale duke trajtuar radikalizimin në burgje dhe duke shkëputur të burgosurit ekstremistë të dhunshëm nga dhuna, mund të ndihmojnë në këtë drejtim. Për të siguruar një përkushtim të qëndrueshëm ndaj kësaj sfide, QKEDH rekomandon edhe forcimin e mekanizmave të shkëmbimit të informacionit midis sistemit të burgjeve dhe strukturave lokale. Kjo do të ndihmonte në monitorimin e veprimeve të të burgosurve pasi ata dalin nga sistemi penitenciar dhe në ofrimin e ndihmës për riintegrimin e tyre.

Gjithashtu, për të parandaluar EDH dhe radikalizimin, rekomandohet dhe përmirësimi i ndërhyrjes sociale dhe ekonomike, duke ofruar ndihmë në kuadër të mekanizmave ekzistues në menyrë “*ad hoc*” për personat e rrezikuar dhe ata që janë kthyer nga zonat e konflikteve për të rritur shanset e tyre për riintegrim në shoqëri.

Lidhur me pyetjen se *profesionistë të cilës fushë kanë nevojë më shumë për trajnime*, QKEDH pasqyron në mënyrë të qartë nevojën për trajnime të personalizuar dhe të vazhdueshme që reflektojnë shumëllojshmërinë dhe rolin e sfidave të secilit profesionist në këtë fushë dhe për ti ndihmuar ata të kuptojnë, identifikojnë dhe adresojnë sa më mirë këtë sfidë. Këto trajnime duhet të përfshijnë oficerët e sigurisë dhe punonjësit e policisë në shkolla, mësuesit dhe punonjësit social të cilët kanë kontakt të drejtpërdrejtë me nxënësit ndaj duhet të jenë të aftë për të identifikuar shenjat e hershme të radikalizimit, të identifikojnë faktorët nxitës dhe të njohin mënyrat e efektshme të ndërhyrjes dhe parandalimit të fenomeneve të tilla.

Gjithashtu, rëndësi i jepet trajnimit të punonjësve të njësisë së mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor për t’u pajisur me njohuritë e nevojshme për të identifikuar situata të ndryshme dhe veprime potenciale të rrezikshme për sigurinë e fëmijëve. Në këtë drejtim edhe ministria e arsimit, në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për EDH ka vënë në jetë plane që trajtojnë këtë tematikë për diskutim në orët e lira në gjithë sistemin para-universitar dhe jo vetëm.

Një grup tjetër profesionistë të fushës që identifikohen nga QKEDH lidhur me nevojën për trajnime janë psikologët dhe punonjësit socialë për të kuptuar thellë motivet si dhe për të gjetur mënyrat e efektshme të ndërhyrjes ndaj individëve të radikalizuar. Ata janë të përfshirë në trajtimin dhe ndihmën për këta individë, dhe njohuritë e tyre janë të rëndësishme për të adresuar këtë sfidë komplekse.

Po kështu QKEDH rritet rëndësinë e trajnimit të personelit të institucioneve penitenciare duke evidentuar rolin që ata luajnë në trajtimin dhe rehabilitimin e personave të prekur nga EDH. Pajisja e këtyre profesionistëve me njohuri të qëndrueshme për faktorët që ndikojnë në radikalizim dhe aftësi për ndërgjegjësimin e këtyre individëve janë elementë thelbësorë për të siguruar që personat nën mbikëqyrje të ndjekin rrugëtimin e duhur të riintegrit pas lirit.

Një fokus të veçantë QKEDH i jep rëndësisë së trajnimeve për profesionistët që janë të përfshirë në monitorimin dhe menaxhimin e flukseve të informacionit dhe komunikimit në rrjetet sociale. Përdorimi i mediave sociale ka bërë që propaganda ekstremiste të jetë më e arritshme dhe e dukshme për audiencën e gjerë. Prandaj, njohuritë e tyre për të identifikuar, analizuar, parandaluar dhe kundërshtuar efektivisht këtë propagandë është thelbësore për të kundërshtuar radikalizmin dhe për të parandaluar përhapjen e ideologjive ekstremiste. Përmes trajnimit, ata mund të bëhen më të aftë në kuptimin e mënyrave se si operojnë grupet ekstremiste në rrjetet sociale dhe si të reagojnë ndaj tyre në mënyrë proaktive për të mbrojtur shoqërinë nga rreziku i radikalizmit të dhunshëm. Një hap tjetër pozitiv, në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në Strategjinë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023-2025, është dhe *bashkëpunimi që QKEDH ka bërë me Shkollën e Magjistraturës* si një institucion kyç në trajnimin e profesionistëve të drejtësisë, përfshirë prokurorët dhe gjyqtarët, për të trajtuar dhe kuptuar çështje që lidhen me radikalizmin dhe EDH.

Pyetja e radhës drejtuar QKEDH mori shkas pikërisht nga rreziku që paraqet shfrytëzimi i teknologjisë për qëllime radikalizmi duke përbërë sfidën më të madhe të shekullit të 21-të. Interneti dhe rrjetet sociale kanë shndërruar mënyrën se si njerëzit komunikojnë, ndajnë informacion, dhe konsumojnë përmbajtje. Në këtë mjedis virtual, ekstremistët dhe grupet radikale gjejnë një platformë të përsosur për të propaganduar dhe rekrutuar, veprimtari që po rrit radikalizmin dhe ekstremizmin. Ky rrezik i mediave online kërkon përgjigje të sofistikuara dhe bashkëpunim ndërkombëtar për të kundërshtuar përhapjen e ideologjive radikale dhe të dhunshme në botën dixhitale. QKEDH ju kërkua nëse janë marrë masa për të adresuar këto problem dhe si dhe lidhur me bashkëpunimin me institucione përgjegjëse për monitorimin apo rritjen e rolit të shoqërisë civile.

QKEDH shpjegon se për t'ju përgjigjur kësaj sfide, ka marrë masa konkrete për raportimin dhe identifikimin e përmbajtjeve të paligjshme në bashkëpunim me Autoritetin e Kontrollit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Shqipërisë

(AKCESK) dhe Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA)²⁰. Për të inkurajuar raportimin e këtyre përmbajtjeve të rrezikshme, QKEDH ka vendosur në dispozicion në faqen e internetit zyrtar²¹ një *link* që te drejton tek "Red Button" në portalin "Raporto Përmbajtje të Paligjshme," të AKCESK. Ky sistem raportimi menaxhohet si portal nga AKCESK në bashkëpunim me Policinë e Shtetit dhe në veçanti me Drejtorinë e Krimit Kibernetik , duke e bërë të mundur për çdo person apo institucion, të raportojë për përmbajtje të dyshimta. Autoritetet publike, në bashkëpunim me AKCESK, kryejnë verifikimin e këtyre raportimeve dhe ndërmarrin masa të menjëhershme ndaj përmbajtjeve të paligjshme në përputhje me ligjin.

Një tjetër pikë kyçe është bashkëpunimi që QKEDH ka me organizatat e shoqërisë civile, siç është "Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza (LKGv) dhe Ministrinë e Brendshme. Përmes këtij bashkëpunimi dhe me mbështetjen e BE-së dhe SHBA-së, është themeluar Linja Kombëtare e Ndhmës për Ekstremizmin e Dhunshëm, që ofron ndihmë dhe këshillim për individët që ndjehen të paqartë, të painformuar ose të rrezikuar nga këto fenomene dhe ku mund të marrin udhëzime dhe informacion konkrete, këshillim dhe mbështetje të specializuar se si t'i trajtojnë këto situata. Ky partneritet, i jetësuar më datë 18 Shkurt 2021 nëpërmjet vënies në funksion të linjës 08004545 është një ndërhyrje konkrete për të ndihmuar në ndërgjegjësimin dhe parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në komunitetet lokale. Për të përmirësuar kontributin e shoqërisë civile në këtë drejtim, është e rëndësishme të vazhdohet dhe përforcohet ky partneritet dhe të ndërmerren masa shtesë për të adresuar shqetësimet e komunitetit në mënyrë efikase.

Një pyetje tjetër me tepër interes drejtuar QKEDH ka të bëjë me *masat që janë marrë nga ky institucioni në lidhje me kthimin e luftëtarëve të huaj terroristë dhe familjeve të tyre, ndarja e praktikave të mira si dhe sfidat kryesore me të cilat përballlet institucioni i QKEDH në këtë fushë.*

Qeveria Shqiptare dhe QKEDH ka ndërmarrë masa të rëndësishme në lidhje me kthimin e luftëtarëve të huaj terroristë dhe familjeve të tyre. Deri tani nuk ka regjistruar asnjë kthim të burrave të radikalizuar nga zonat e konfliktit, por nëpërmjet 4 misionesh të riatdhesimit që qeveria ka ndërmarrë është bërë i mundur kthimi nga Siria dhe Iraku i 27 shtetaseve shqiptare gra dhe 11 fëmijë. Aktualisht, këta shtetas janë në proces riintegrimi në komunitetet ku janë vendosur dhe ndiqen me PIM të hartuara për secilën familje nga PMF në bashkëpunim me të gjithë aktorët e përfshirë në GTN dhe nën

²⁰ Marrëveshje Bashkëpunimi me Autoritetin e Mediave Audiovizive dhe Qendrën e Koordinimit Kundër Ekstremizmit Te Dhunshëm, 27.01.2021, i disponueshëm tek <https://cesk.gov.al/ep-content/uploads/2020/07/Mou.pdf>;

²¹ [ëëë.cve.gov.al](http://ee.cve.gov.al);

koordinimin dhe monitorimin e QKEDH. Gjithashtu këtyre familjeve ju është ofruar mbështetje humanitare, psikologjike, edukative dhe programe sportive për fëmijët të cilët janë rregjistruar, sipas grupmoshës, në institucionet e arsimit përkatës ku ndjekin procesin mësimor. Gjithashtu, të gjithë fëmijët e kthyer nga zonat e luftës ndiqen me PIM të hartuar nga MAS, mësuesi mbështetës nën monitorimin e QKEDH. Një fokus të veçantë QKEDH, nëpërmjet institucioneve të pushtetit vendor dhe OSHC-ve mbështetëse i ka kushtuar fuqizimit ekonomik të grave të kthyer, përmes aftësimit profesional me qëllim punësimin në të ardhmen madje njëra prej tyre është mbështetur në hapjen e një aktiviteti tregtar. Megjithëse QKEDH vazhdon të koordinojë dhe monitorojë zbatimin e procesit të Rehabilitimit, Riintegritit dhe Risocializimit (RRR) të të kthyerëve duke ndërmarrë masat e nevojshme për përgatitjen e shërbimeve publike dhe komuniteteve për kthimin e individëve të tjerëve nga zonat e konfliktit, sfidat e kësaj fushë mbeten të shumta dhe komplekse.

Lidhur me pyetjen se *cilat aspekte të ndërveprimit institucional kanë nevojë të përmirësohen*, QKEDH nuk ka dhënë një përgjigjë të qartë por ka theksuar se në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga Strategjia Ndërsektoriale për Parandalimin e EDH dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023-2025 si dhe misionit të saj, QKEDH bashkëpunon me ministrinë e linjës, duke përfshirë Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale etj. si dhe institucionet në varësi të tyre. QKEDH ka gjithashtu një bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë e Tiranës, Bashkinë Cërrik etj. Ky ndërveprim është krijuar për të përmirësuar koordinimin e procesit të kthimit dhe integritit të kthyerëve nga zonat e konfliktit dhe për të adresuar sfidat e tyre në mënyrë më efikase.

Në kontekstin e *bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit*, QKEDH është në kontakt të rëndësishëm me Qendrën e Ekselencës së NATO-s për çështje të sigurisë. Kjo lidhje është e rëndësishme për shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin e masave të ndërmarrë për të parandaluar ekstremizmin dhe radikalizmin. QKEDH raporton në Ministrinë e Linjës për çështje të ndryshme të sigurisë dhe ka një bashkëpunim të ngushtë me departamentin e veçantë në Qendrën e Ekselencës së NATO-s në lidhje me raportet dhe informatat relevante për sigurinë. Ky bashkëpunim ndihmon në përmirësimin e kapaciteteve dhe njohurive të QKEDH për të adresuar sfidat e EDH dhe radikalizmit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

QKEDH, gjithashtu, ka ndërtuar *një rrjet të gjerë bashkëpunimi në nivel rajonal dhe ndërkombëtar për të adresuar sfidat e radikalizmit dhe EDH*, si dhe për të përkrahur proceset e rehabilitimit, ri-integrimit dhe ri-socializimit të të rikthyerëve nga ish zonat e konfliktit.

Kjo përfshin partnerë të rëndësishëm si UNICEF, USAID, OSBE, KiE, GCERF, Hedayah, IOM, KShH dhe Ambasadat e vendeve partnere si SHBA, Mbretëria e Bashkuar, Mbretëria e Holandës dhe partnerë të tjerë ndërkombëtarë. Ky bashkëpunim është kritik për të përforcuar kapacitetet e QKEDH dhe për të siguruar që përpjekjet për parandalimin dhe kundërshtimin e EDH të jenë efektive në nivel kombëtar dhe global.

Drejtoria e Anti-terrorit ne Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit

Një aspekt i rëndësishëm për parandalimin e EDH dhe luftën kundër radikalizimit është *ndërveprimi institucional*. Nëpërmjet përgjigjes së saj, Drejtoria e Anti-terrorit ne Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit tregon se nuk janë evidentuar problematika në ndërveprimin institucional me institucionet e tjera. Ky vlerësim pozitiv shënon një nivel të mirë të bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitutional në fushën e parandalimit dhe luftës kundër radikalizimit të dhunshëm dhe ekstremizmit. Në një kontekst ku koordinimi i efektshëm dhe bashkëpunimi ndërmjet institucioneve është thelbësor për adresimin e sfidave të sigurisë, mungesa e problematikave në ndërveprim është një fakt pozitiv që ndihmon në përmirësimin e kapaciteteve të përbashkëta dhe efikasitetit të masave të ndërmarra për të parandaluar dhe luftuar EDH dhe radikalizmin në Shqipëri. Administrimi i kthimeve të grave dhe fëmijëve nga zonat e konfliktit ka dëshmuar gjithashtu një bashkëpunim efektiv mes DPSH dhe SHISH.

Ndërkohë, kjo Drejtori vlerëson se strukturat e Policisë së Shtetit janë tashmë të pajisura me *kapacitetet operacionale dhe logjistikë* e nevojshme për të kryer operacione speciale që ndihmojnë në parandalimin dhe goditjen e veprave penale me karakter terrorist. Megjithatë, ata theksojnë se është e rëndësishme të vazhdojë investimi dhe mbështetja e vazhdueshme për përditësimin e kapaciteteve në përpunime me zhvillimet teknologjike dhe kërcënimet e ndryshme të terrorizmit. Trajnime të vazhdueshme janë kryer për të përmirësuar kapacitetet profesionale dhe logjistike të të gjitha strukturave të policisë për të përballur me sukses situatat e ndryshme që lidhen me luftën kundër terrorizmit. Raportohet se kërcënimi i terrorizmit në Shqipëri është në nivel të ulët, përjashtuar disa raste ku është vlerësuar si "mesatar". Në të kaluarën, Shqipëria është prekur nga fenomeni i pjesëmarrjes së luftëtarëve të huaj terroristë, të cilët janë zhvendosur së bashku me familjet e tyre në zonat e konfliktit. Policia e Shtetit është përfshirë në misionet e riatdhesimit në Siri në vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 për të kthyer familjarët e tyre në Shqipëri.

Lidhur me pyetjen *nëse kanë qënë të mjaftueshme rishikimet që i janë bërë Kodit Penal në vitin 2014 dhe masat shtrënguese të parashikuara për veprat penale që lidhen me EDH dhe radikalizimin*, Drejtoria e Antiterrorit ka paraqitur një analizë të hollësishme të legjislacionit të zbatuar për luftën kundër terrorizmit dhe po punon për të përpunur plotësisht kuadrin ligjor me *acquis* të Bashkimit Evropian në këtë fushë. Ata argumentojnë

se legjislacioni shqiptar i orientuar kundër terrorizmit është i gjerë dhe është përmirësuar ndjeshëm në ndjekje të zhvillimeve ndërkombëtare. Drejtoria e Antiterrorit nënvizon se, pas rishikimit të vitit 2014, Shqipëria nuk ka regjistruar asnjë rast zyrtarisht të individëve që janë shkuar në vendet e konfliktit Siri-Irak. Ata theksojnë se Shqipëria ka në vend një kuadër ligjor dhe mekanizma institucionalë të efektshëm për të adresuar sfidat e radikalizmit dhe parandaluar EDH në vend.

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF)

Një institucion tjetër i rëndësishëm mes aktorëve të përfshirë në sfidën e luftës kundër EDH dhe radikalizimit është Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF) e cila ka për qëllim monitorimin e kuadrit ligjor dhe koordinimin e veprimeve për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Përgjigja e ASHDMF lidhur me pyetjes se *çfarë duhet të përmirësohet në aspektin e rehabilitimit të fëmijëve të kthyer nga zonat e konfliktit* tregon se ka një nevojë të tillë. Përmirësimi i situatës lidhet me nevojën e rritjes së kapaciteteve të profesionistëve të vijës së parë dhe organizimin e trajnimeve që të trajtojnë menaxhimin e rasteve të kësaj natyre. Gjithashtu thekson nevojën e hartimit të planeve lokale ose të buxhetuara, nga bashkitë, për ofrimin e shërbimeve mbështetëse dhe rehabilituese për këtë grup të veçantë të fëmijëve. Në këtë kontekst, duhet të fuqizohen shërbimet ekzistuese dhe të kryhen shërbime të reja që të trajtojnë këtë tipologji të re rastesh. Gjithashtu, për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm të fëmijët, është e rëndësishme të rriten shërbimet me bazë komunitare dhe të ofrohen shërbime mbështetëse për familjet, duke përfshirë edhe programe dhe aktivitete edukative. Këto përmirësime do të ndikojnë pozitivisht në rehabilitimin dhe riintegrimin e fëmijëve të kthyer nga zonat e konfliktit dhe në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm të kësaj kategorie të popullsisë.

Gjithashtu pyetjes rreth *nevojës për rritje të kapaciteteve*, ASHDMF, identifikon nevojën për rritjen e numrit të psikologëve të cilët janë të disponueshëm për të punuar në shkolla dhe në ambiente policie si një kontribut kyç në parandalimin e EDH dhe radikalizmit. Kjo masë do të mundësonte identifikimin më të hershëm të fëmijëve në rrezik të radikalizimit dhe ofrimin e trajtimit të nevojshëm. Po ashtu, rritja e numrit të psikologëve të punësuar në ambiente policie do të ndikonte në zvogëlimin e vonesave gjatë vlerësimit të rasteve të fëmijëve të radikalizuar, duke e bërë më efikase dhe të shpejtë trajtimin dhe monitorimin e tyre për të parandaluar përkeqësimin e situatës. Kjo përparim do të ndihmonte në përmirësimin e përgjithshëm të kapaciteteve për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm tek fëmijët. Në këtë drejtim ministria e arsimit ka ndërmarrë masa konkrete duke shtuar numrin e punonjësve socialë nëpër shkolla.

Sikurse dhe institucioneve te tjera, ASHDMF ju kërkua opinioni se *si mund të rritej roli i shoqërisë civile për të ndërtuar qëndrueshmërinë e komunitetit*. Në përgjigjen e saj Agjencia theksoi rëndësinë e rolit të organizatave të shoqërisë civile në rritjen e ndërgjegjësimit të komuniteteve në lidhje me EDH. Këto organizata mund të kontribuojnë në informimin e shoqërisë, fëmijëve, prindërve dhe profesionistëve në lidhje me pasojat dhe dëmet që shkakton radikalizmi dhe EDH. Ata mund të organizojnë shërbime parandaluese dhe të angazhohen në adresimin e fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm, duke përfshirë takime informuese dhe trajnime me profesionistët. Kjo përjasje e organizatave të shoqërisë civile është kritike për përmirësimin e qëndrueshmërisë në komunitetet lokale dhe për parandalimin e përhapjes së ekstremizmit tek fëmijët dhe të rinjtë.

Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve (DPB)

Një grup pyetjesh specifike ju drejtua dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB) si një institucion që ka një rol të rëndësishëm në trajtimin dhe rehabilitimin e personave të dënuar, duke përfshirë edhe ata që kanë marë pjesë në veprimtari terroriste. Kjo sfidë kërkon përpjekje të përbashkëta nga të gjitha hallkat e sistemit penal dhe aktorët e tjerë në përpjekjen për të siguruar një shoqëri të mëtejshme të sigurtë dhe të qëndrueshme. Bazuar në përgjigjen e DPB rezulton se në sistemin tonë të burgjeve janë aktualisht 9 shtetas shqiptar dhe 1 shtetas i huaj, të dënuar për vepra me qëllime terroriste ndërkohë që gjatë 5 viteve të fundit janë liruar 5 persona që kanë qënë të dënuar për vepra penale për qëllime terroriste. Pyetjes *nese janë identifikuar në sistemin e burgjeve shtetas me potencial dhe risk radikalizmi që çon në shfaqje të EDH*, DPB shpjegon nuk janë identifikuar persona të dyshuar si të radikalizuar përveç atyre që janë të dënuar për vepra të qëllimeve terroriste. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se ekziston një potencial i rrezikshëm që të burgosurit mund të përballen me radikalizimin gjatë qëndrimit të tyre në burgje për shumë arsye, përfshirë mungesën e ndihmës rehabilituese adekuate, kontakte me personat e radikalizuar brenda burgut ose jashtë tij, dhe kushtet e tjera që mund të rrisin vulnerabilitetin e tyre ndaj influencave ekstremiste. Indoktrinimi i të rinjve në mjediset penitenciare mbetet një sfidë aktuale.

Përsa i përket pyetjes se *a ka patur ngjarje me elementë të radikalizmit që kanë ndodhur në këto 5 vitet e fundit dhe mund të kenë sjellë apo mund të sjellin forma të ekstremizmit*, përgjigja tregon që ky incident konkret është një shembull i tillë. Përgjigja e DPB përshkruan një ngjarje të rëndësishme në sistemin penitenciar të Shqipërisë, konkretisht grevën masive në burgun e Peqinit që ndodhi në tetor të vitit 2021, e cila u nxit dhe organizua nga të dënuar për vepra me qëllime terroriste. Sigurisht, përmendet se ky incident është menaxhuar mirë nga stafi, dhe një prej të burgosurve është vendosur në regjim të posaçëm 41/Bis. Kjo përgjigje tregon se radikalizmi dhe ekstremizmi janë sfida të cilat mund të ndikojnë

në sistemin penitenciar dhe që duhet adresuar me kujdes dhe përgjegjshmëri nga autoritetet kompetente për të parandaluar rreziqet e mundshme dhe për të siguruar që këto ngjarje të trajtohen me sukses. Për këtë arsye PSV për vlerësim të vazhdueshëm, mbështetja psikologjike, forcimi i sektorit të analizës si dhe protokolli për shkëmbime informacioni të brendshme në sistemin e burgjeve dhe ndërinstytucionale me autoritete të tjera të sigurisë dhe jo vetëm, janë elemente kyç në parandalimin dhe luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Ky faktor tregon se duhet vendosur fokusi në zhvillimin e programeve të rehabilitimit dhe parandalimit të radikalizmit që të burgosurit të kenë më shumë mundësi për të ndryshuar mendësinë e tyre dhe për të reduktuar rrezikun e radikalizimit të dhunshëm në të ardhmen. Kjo lidhet dhe me pyetjen vijuese *se si realizohet procesi i rehabilitimit dhe riintegritetit të shtetasve që janë potencial dhe në risk radikalizimi*. Përgjigjja e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve paraqet një përpjekje të ndërmarrë në drejtim të rehabilitimit të të burgosurve që janë në rrezik radikalizimi. Në rradhë të parë janë ndërmarrë sesione trajnuese për personelin e burgjeve në bashkëpunim me QKEDH, organizata ndërkombëtare të njohura, si KiE, OSCE, dhe KShH, me qëllim përmirësimin e kapaciteteve të tyre për të trajtuar sfidat e radikalizimit. Gjithashtu janë hartuar dhe miratuar instrumenta vlerësues të indikatorëve të lidhur me ekstremizmin, si dhe plani individual i ndërhyrjeve dhe programeve të rehabilitimit, që tregon se ka një përpjekje për të adresuar këtë çështje komplekse. Një shembull i mirë është burgu i Peqinit të burgosurve u ofrohet trajnim dhe aftësim profesional në fushën elektrike, duke shënuar një hap pozitiv drejt rehabilitimit dhe zvogëlimit të rrezikut të radikalizimit të dhunshëm të tyre. Megjithatë, është e rëndësishme të vazhdojnë përpjekjet në këtë drejtim dhe të sigurohet një përqendrim më i madh në përmirësimin e programeve të rehabilitimit për të përmirësuar rezultatet e tyre në parandalimin e radikalizimit.

Po me kaq rëndësi është *fuqizimi protokolleve, masave dhe fokusi i shtuar në trajnimin e personelit të burgjeve*, veçanërisht ata të vijës së parë, që janë të angazhuar si persona kontakti me të dënuarit. Në këtë kontekst, është thelbësore thellimi i interpretimit dhe gjykimin klinik nga stafi i specializuar. Ky hibrid i përvojës praktike dhe njohurive të thelluara mund të sigurojë një qasje më të ndërlikuar dhe të personalizuar ndaj çdo të burgosuri, duke i ndihmuar ata të kuptojnë dhe të trajtojnë shkaqet thelbësore të radikalizimit potencial. Ky përqendrim në trajnim dhe profesionalizim është thelbësor për të përballuar sfidat e radikalizimit në sistemin e burgjeve me një qasje më të ndjeshme dhe efikase. DPB thekson gjithashtu nevojën për një nivel më të lartë të mbështetjes praktike në krahasim me njohuritë teorike lidhur me identifikimin e hershëm, menaxhimin dhe rehabilitimin e të burgosurve. Megjithëse njohuritë teorike janë themelore për të

kuptuar dinamikën e radikalizimit dhe proceset e shenjave të mundshme, aplikimi i tyre në një kontekst praktik është një sfidë e veçantë. Prandaj, kërkohet një përqendrim më i madh në zhvillimin e aftësive praktike të personelit të burgjeve, duke përfshirë teknika efikase të trajtimit dhe menaxhimit të të burgosurve. Kjo mund të përfshijë trajnime dhe përkrahje të vazhdueshme për stafin, duke përfshirë ndarjen e praktikave të mira dhe njohurive të arritura nga përvoja në terren dhe nga eksperiencia e marrë nga shtete partnere në rajon dhe jo vetëm.

Lidhur me *kapacitetet e strukturave të DPB*, përgjigja e marrë paraqet një vlerësim se stafi i këtyre strukturave është i mjaftueshëm për të menaxhuar dhe trajtuar personat e dënuar, duke përfshirë edhe rastet e veçanta siç janë të kthyerit nga zonat e konfliktit. Për momentin, nuk ka të dhëna për të kthyer nga zonat e konfliktit të cilët ndodhen në sistemin e burgjeve por më shumë duhet të intensifikohen përpjekjet institucionale në drejtim të parandalimit të këtyre fenomeneve. Përveç kësaj ka dhe një rritje të numrit të psikologëve që shërbejnë në sistemin penitenciar në shkallë vendi, që mund të kontribuojnë në parandalimin, evidentimin e hershëm dhe adresimin e këtyre fenomeneve në burgje. Janë rreth 45 profesionistë të tillë por nevojitet trajnim i posaçëm për specifikat që ka sistemi penitenciar.

Ky fakt mund t'i japë përmasa pozitive sistemit penal në përgatitjen dhe parandalimin e rrezikut që personat e kthyer nga këto zona të përfshihen në aktivitete radikale. Po ashtu, fakti që stafi është i trajnuar dhe janë hartuar plane veprimi të posaçme për të trajtuar rastet e të kthyerve nga zonat e konfliktit tregon përgatitjen dhe gatishmërinë e institucionit për të menaxhuar sfidat që mund të sjellë kthimi i këtyre personave. Megjithatë, është e rëndësishme që kjo përgatitje dhe gatishmëria të vazhdojnë të mbeten të përditësuara dhe të përmirësuara për të përballuar ndryshimet në këtë kontekst të ndjeshëm. Në lidhje me personelin e burgjeve, DPB u pyet *nëse janë të pajisur me certifikatë sigurie punonjësit që administrojnë të dhënat e LHT*.

Në lidhje me çështjen e *pajisjes me certifikatë siguri të punonjësve që administrojnë të dhënat e LHT*, DPB informon se në varësi të funksionit që kanë, personeli është i pajisur me certifikatë sigurie dhe një pjesë janë në proces për marrjen e saj.

DPB gjithashtu ju drejtua pyetja nëse nga këndvështrimi i institucionit të tyre *e vlerësonin të mjaftueshme rishikimet e KP të vitit 2014 lidhur me veprat penale të EDH dhe në gjykimin e këtij institucioni KP është i kompletuar përsa i përket trajtimit të veprave penale që lidhen me terrorizmin*.

Shërbimi i Provës

Një grup i dedikuar pyetjesh i janë drejtuar dhe institucionit të Shërbimit të Provës, ku njëra prej tyre lidhej me *përgatitjen dhe kapacitetet që ka ky institucion për të pritur dhe trajtuar rastet e të kthyerve nga zonat e konfliktit, duke përfshirë Luftëtarët e Huaj Terroristë, të kthyerat femra dhe fëmijët e mitur*. Ky informacion është kritik për të kuptuar se sa efektive janë përpjekjet e institucionit të Shërbimit të Provës në rehabilitimin dhe riintegrimin e këtyre individëve dhe se sa kapacitete janë të disponueshme për të adresuar sfidat e tyre të veçanta në rrugën e rikthimit në shoqëri dhe shmangies së rikthimit në aktivitete ekstremiste.

Në përgjigjen e tyre, Shërbimi i Provës thekson se ata nuk kanë struktura të veçanta të krijuara për trajtimin ose parandalimin e radikalizimit dhe EDH dhe në disa raste kanë marrë pjesë në seminare dhe konferenca me tematika informuese për të përmirësuar njohuritë dhe ndërgjegjësimin e tyre në këtë fushë. Por në përgjigjen e tyre venë theksin mbi rëndësinë që ka ndërmarrja e hapave të rëndësishëm për fuqizimin e kapaciteteve të tyre në luftën kundër radikalizmit dhe EDH. Ata e vlerësojnë se ngritja e strukturave specializuar, trajnimi i stafit, përmirësimi i kapaciteteve të personelit dhe zhvillimi i infrastrukturës janë elementë kyç për të përmirësuar efikasitetin e tyre në trajtimin dhe parandalimin e kësaj dukurie. Për më shumë nevojitet të ndërmerren hapa konkretë për të përshtatur formatet e intervistimit, mjediset e posaçme dhe planet individuale të trajtimit të rasteve.

Kjo qasje tregon për seriozitetin e tyre ndaj sfidave të radikalizmit dhe angazhimit për të ndërtuar një kornizë të përshtatshme institucionale për t'u përballuar me këtë fenomen në mënyrë më të ndërgjegjshme dhe efikase. Deri më tani referohet se akoma nuk kanë pasur një rast të kësaj kategorie në trajtim duke konsideruar që këto raste janë menaxhuar në kuadrin ligjor nën fushën e përgjegjësisë së SPAK.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore/Bashkitë

Riintegrimi i luftëtarëve të huaj terroristë që janë kthyer në vendet e tyre të origjinës është një sfidë komplekse për institucionet përfshira po edhe për shoqërinë në përgjithësi. Përpjekjet për të rikthyer dhe integruar individët që janë prekur nga ky fenomen kanë qenë thelbësore për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në vend. Në përgjigje të kësaj sfide, bashkitë, duke qenë më afër realitetit dhe nevojave të komunitetit, kanë një rol kyç në përpjekjet për të siguruar integrimin social dhe ekonomik të LHT si dhe të individëve të prekur nga fenomeni radikalizmit. Në të njëjtën kohë, Bashkitë, kanë përgjegjësinë për adresimin e sfidave etike që dalin nga respektimi i të drejtave të këtyre individëve dhe familjeve të tyre, duke i trajtuar këto çështje një kujdes të shtuar.

Duke qenë se bashkitë kanë lidhje të ngushta me komunitetet e tyre, kanë një rol thelbësor në parandalimin e rritjes së rrezikut të radikalizimit të mëtejshëm. Ata janë në pozicionin më të mirë për të zbuluar dhe adresuar faktorët e riskut në komunitet, duke synuar parandalimin e rekrutimit të individëve të tjerë dhe ndikimin negativ të ekstremizmit të dhunshëm. Gjithashtu, Bashkitë kanë një detyrë të rëndësishme në sigurimin e qëndrueshmërisë të procesit të riintegrimi të LHT-ve dhe familjeve të tyre. Kjo qëndrueshmëri deri tani ka qenë e organizuar në koordinim me QKEDH nëpërmjet rolit të rëndësishëm të GTN-ve dhe KVSP-ve aty ku rezultojnë të ngritura dhe funksionale.

Në kuadër të këtij studimi, u përpiluan disa pyetje për institucionet në nivel qendror dhe lokal lidhur me sfidat që ata hasin në lidhje me procesin e intergrimit të LHT dhe familjeve të tyre.

Nga përgjigjet e grumbulluara nga bashkitë për pyetjen se *nga e merr informacionin bashkia për procesin e rehabilitimit dhe riintegrimin të individëve të prekur nga fenomenet e ekstremizmit të dhunshëm ose radikalizmit*, u vërejt se bashkitë e marrin informacionin e tyre për riintegrim nga burime të ndryshme. Disa bashki, siç është Bashkia Tiranë, kërkon referime dhe informacion nga Qendra Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm për të ndihmuar në rehabilitimin dhe riintegrimin e individëve të prekur. Ky qëndrim tregon se Bashkia Tiranë është përfshirë në një bashkëpunim të ngushtë me një autoritet qendror, sic është CVE, për të adresuar këtë çështje komplekse.

Në anën tjetër, Bashkia Kamëz e merr informacionin nga institucioni referues, ku është vendosur rasti, dhe angazhohet në procesin e rehabilitimit dhe riintegrimi të tyre, duke respektuar termat e përcaktuara në ligjin për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

Ndryshe nga këto dy bashki, Bashkia Pogradec nuk ka marrë informacion nga institucionet përgjegjëse që trajtojnë fenomenin e radikalizmit dhe ekstremizmit. Kjo tregon për një situatë të ndryshme në këtë zonë, ku problemi i ekstremizmit është më i kufizuar.

Përsa i përket Bashkisë Vorë, edhe pse në këtë bashki nuk janë identifikuar individë që janë të prekur nga fenomenet e ekstremizmit të dhunshëm apo radikalizmit, ajo vlerëson informacionin që merr nga bashkëpunimi i ngushtë dhe i vazhdueshëm me NjMF dhe Komisariatit të Policisë, i cili është thelbësor në monitorimin dhe parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Ndërsa, Bashkia Cërrik informacionin lidhur me procesin e rehabilitimit dhe riintegrimin të individëve të prekur nga fenomenet e ekstremizmit të dhunshëm ose radikalizmit e

merr përmes identifikimit të këtyre individëve nga specialistët e sektorit të shërbimit social dhe bashkëpunimit të ngushtë me komunitetin dhe policimin në komunitet

Lidhur me pyetjen nëse kanë identifikuar individë të prekur nga fenomenet e ekstremizmit të dhunshëm ose radikalizmit dhe çfarë kategorish përfaqësojnë ato (luftëtarë të huaj të kthyer nga lufta në Siri, Irak, familjarë të tyre), Bashkitë paraqesin një tablo interesante rreth identifikimit dhe menaxhimit të individëve të prekur nga fenomenet e ekstremizmit të dhunshëm ose radikalizmit në Shqipëri.

Bashkia Tiranë për periudhën Janar – Gusht 2023 nuk ka identifikuar individë të prekur nga ky fenomen, por është përfshirë në menaxhimin e rasteve të të kthyerve nga zonat e konfliktit, të cilat janë referuar nga Qendra Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm.

Në Bashkinë e Kamzës është identifikuar një rast i një familjeje, ku tre fëmijë janë prekur nga fenomeni i ekstremizmit si rrjedhojë e ndikimit të bindjeve fetare ekstreme të prindërve deri aty sa fëmijët ishin privuar nga shkolla. Ky rast, i cili është identifikuar nga një organizatë e shoqërisë civile, tregon për një sfidë serioze për adresimin e së cilës Bashkia Kamëz ka bashkëpunuar me strukturat e shërbimeve sociale dhe ndihmën psikologjike për fëmijët dhe familjen.

Bashkia e Cërrikut raporton se kanë konstatuar 4 familje në koordinim me autoritetet publike, prej të cilëve 6 të rritur dhe 11 fëmijë, të prekur nga fenomeni i EDH. Kryesisht këta individë që preken nga këto fenomene i përkasin grupeve vulnerabël të parashikuar për mbështetje në skemat socio-ekonomike.

Sipas informacionit të marrë nga Bashkitë e Pogradecit dhe Vorës, konstatohet se nuk janë identifikuar individë të prekur nga fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm ose radikalizmi në këto bashki.

Trajtimi dhe mbështetja për individët e prekur nga ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizmi në Shqipëri vazhdon të përbëjë një sfidë të rëndësishme dhe komplekse për institucionet, organizatat dhe komunitet e përfshira. Megjithatë, disa prej tyre kanë zhvilluar qasje të veçanta për të asistuar të kthyerit nga zonat e konfliktit në mënyra të ndryshme në drejtim të mbrojtjes së fëmijëve, kujdesit shëndetësor, arsim, dhe fuqizim ekonomik. Këto përpjekje janë të rëndësishme në riintegrimin e këtyre individëve dhe në aspektin e zvogëlimit të riskut të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në këtë grup. Kjo vihet re dhe në përgjigjet e pyetjes nëse kanë trajtim të veçantë këta individ, të cilët janë të prekur nga fenomenet e radikalizmit dhe EDH dhe që u përkasin njëherësh disa prej kategorive të vulnerabilitetit për të cilat parashikohet mbështetje me shërbime.

Në përgjijje të kësaj pyetje Bashkia Tiranë informon se ka ndërtuar një qasje të veçantë dhe të përpiktë në trajtimin dhe riintegrimin e rasteve të individëve të kthyer nga zonat e konfliktit. Kjo qasje është ndërtuar mbi themelet e një **metodologjie pune** që vendos në qendër fëmijën dhe ka një orientim thelbësor drejt mbrojtjes dhe përmirësimit të jetës së tyre. Metodologjia e punës është fryt i një sërë trajnimesh paraprake nga profesionistë të disa fushave zhvilluar në kuadër të një angazhimi konstant nëpërmjet krijimit të një Grupi Teknik Ndërsektorial (GTN) që kanë hartuar Plane Individuale Mbrojtje (PIM) për çdo familje "të kthyer" në trajtim, nën koordinimin e vazhdueshëm të QKEDH-së.

Ky angazhim ka ardhur si pasojë e një legjislacioni të plotësuar në Shqipëri, që synon të ndërtojë një sistem të integruar për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në përgjithësi si dhe atyre në rrethana të veçanta sic është rasti i fëmijëve të kthyer nga zonat e konfliktit.

Një nga parimet kyçe të kësaj qasje është që "fëmija nuk menaxhohet i ndarë nga familja, por PIM ngrihet duke përfshirë edhe ndërhyrje me masa të veçanta për familjen e fëmijës. Ky parim thelbësor thekson rëndësinë e kujdesit ndaj marrëdhënieve familjare dhe bashkëpunimit me prindërit dhe kujdestarët për të siguruar mjedisin më të mirë të mundshëm për fëmijët në proces riintegrimi.

Figura kyçe e këtij procesi është PMF që luan dhe rolin e menaxherit të rastit. PMF mbledh dhe analizon informacionin lidhur me secilin rast dhe koordinon aktivitetet e nevojshme. GTN është gjithashtu një hallkë e rëndësishme që përdoret për të hartuar dhe rishqyrtuar PIM për secilin fëmijë, duke siguruar që trajtimi të jetë sa më i personalizuar dhe efikas.

PIM i hartuar individualisht për secilin fëmijë është një instrument i fuqishëm që përdoret për të ofruar shërbime të nevojshme dhe të përshtatshme. Disa nga këto shërbime përfshijnë sigurimin e një kujdestari në familje, trajtimin e rasteve me probleme shëndetësore, furnizimin me ushqim, ofrimin e kujdesit psikologjik, fizioterapinë, këshillimin shëndetësor, rregjistrimin në institucionet shkollore dhe sigurimin e kushteve të jetesës, duke përfshirë pagesën e qerasë së shtëpive dhe faturave të ujit dhe dritave si dhe mbikqyrjen e procedurave ligjore për rregjistrimin e fëmijëve në Rregjistrin e Gjendjes Civile.

Të gjitha këto ndërhyrje të sipërpërmendura janë kryer nën frymën e një qasje të integruar dhe gjithëpërfshirëse, me asistencën e programeve të mbështetura finaciarisht nga partnerët ndërkombëtarë gjatë viteve 2020-2022, nëpërmjet organizatave të shoqërisë civile në nivel lokal të koordinuara nga QKEDH. Në këtë drejtim duhet të kemi parasysh edhe faktin që ndihma juridike falas e parashikuar nga kuadri ligjor kombëtar përfshin për shtetasit shqiptarë vetëm ndihmën juridike parësore dhe jo dytësore. Për më tepër

nuk përfshin kategorinë e fëmijëve të paregjistruar dhe që nuk janë zyrtarisht shtetas shqiptarë siç është rasti i disa prej të kthyerve, të cilët kanë lindur në zonat e konfliktit në Siri dhe Irak.

Kjo qasje e përkujdesjes ndaj fëmijëve të riatdhesuar nga zonat e konfliktit është një shembull i përpjekjeve të Bashkisë Tiranë për të siguruar një përqasje të plotë dhe integrale në trajtimin dhe mbështetjen e këtyre individëve. Përmes ndihmës së personalizuar dhe një qasjeje të përpiktë, ata janë të përpjekur të sigurojnë një rikthim sa më të suksesshëm dhe të sigurtë në shoqëri për fëmijët e kthyer nga zonat e konfliktit. Kjo qasje thekson vlerën e bashkëpunimit, mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, dhe përkushtimit ndaj zhvillimit të tyre të ardhshëm. Ndryshimi i përshkrimeve të punës duke përfshirë specifikisht detyra dhe përgjegjësi funksionale për menaxhimin e rasteve të të kthyerve është vlerësuar si një arritje e rëndësishme.

Bashkia Kamëz, informon rreth një rasti ku pas arrestimit të një babai për veprën penale “Keqtrajtim i fëmijëve të mitur”, Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve (NjMF) është angazhuar në ndihmën ndaj familjes. NjMF ka monitoruar situatën në familje me vizita dhe kontakte periodike dhe ka ofruar asistencë gjatë procesit gjyqësor si përfaqësues procedural. Njëkohësisht, është bërë dhe kërkesa për të siguruar arsim falas për tre vajzat e familjes, duke konsideruar situatën dhe kushtet specifike të familjes. Gjithashtu fëmijëve i është siguruar shërbimi i këshillimit psikologjik nga një psikolog i pranishëm në shkollë si dhe këshillim për nënën në kuadër të prindërimit pozitiv dhe këshillim për aplikim në zyrën e ndihmës ekonomike.

Në Bashkinë Pogradec dhe Bashkinë Vorë, nuk janë identifikuar individë të prekur nga ekstremizmi i dhunshëm ose radikalizmi, kështu që nuk ka një informacion lidhur me trajtimin e këtyre individëve.

Ndërkohë që Bashkia Cërrik në përgjigjen e saj sqaron se individët dhe familjet e prekura nga EDH nuk marrin ndonjë trajtim të veçantë. Ata trajtohen me të njëjtat skema të ndihmës që trajtohen familjet vulnerabël sipas nevojave të identifikuara nga specialistët e shërbimit social.

Pyetjes lidhur me *bashkëpunimin që bashkitë kanë me QKEDH dhe mbështetjen e marre nga ky institucion*, Bashkia e Tiranës thekson se në këtë mision të ndërlikuar, bashkëpunimi me aktorë profesionistë është kyç për të siguruar mbështetje të plotë për familjet dhe fëmijët e prekur nga ky fenomen. Bashkia e Tiranës ka ndërmarrë një rol kyç në menaxhimin e familjeve të kthyer nga zonat e konfliktit, dhe thekson se ndërhyrja për ofrimin e shërbimeve është e koordinuar, nën përkujdesjen e QKEDH, dhe e ndërlidhur në mënyrë

të hollësishme për të garantuar që çdo hap i marrë në këtë proces të jetë efikas dhe i koordinuar.

Bashkia e Kamzës shpreh një qëndrim të hapur ndaj bashkëpunimit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve të kthyer nga zonat e konfliktit dhe për ofrimin e shërbimeve të përshtatshme sipas nevojave të tyre të veçanta. Edhe pse aktualisht nuk kanë patur raste specifike, angazhohen t'i japin prioritet rasteve të fëmijëve nën moshën 18-vjeç të cilët janë kthyer nga zonat e konfliktit duke raportuar dhe bashkëpunuar me QKEDH.

Në rastin e Bashkisë së Pogradecit, ajo ka ndërtuar një bashkëpunim të ngushtë me QKEDH duke punuar së bashku në evidentimin e fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në komunitetin e tyre dhe kanë siguruar trajnimin e specialistëve të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale dhe Specialistëve të Policimit në Komunitet. Ky angazhim tregon vullnetin e Bashkisë së Pogradecit për të ngritur kapacitetet e tyre për të identifikuar dhe menaxhuar me efikasitet rastet e ekstremizmit të dhunshëm në komunitetin e tyre. Në të njëjtën kohë në këtë zonë në bashkëpunim me QKEDH janë zhvilluar edhe veprimtari për ngritje kapacitetesh dhe trajnime të përfaqësuesëve të rinj fetarë lidhur me këtë temë gjatë 2021-2022 nën koordinimin e KNFSH-së me mbështetjen finaciare nga programi i granteve “Mbi EDh dhe qëndresën e të rinjve” të Ambasadës Amerikane në Tiranë.

Përsa i përket Bashkisë Cërrik, bashkëpunimi me QKEDH është një përpjekje e rëndësishme për të adresuar dhe trajtuar sfidat e individëve dhe familjeve të prekur nga fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm. Nisur që nga dhjetori i vitit 2019, Instituti për Aktivizëm dhe Ndryshim Social, në bashkëpunim me QKEDH, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkinë Cërrik, ka zbatuar një program 2-vjeçar për rehabilitimin dhe riintegrimin e 9 familjeve në situata sociale të vështira.

Ky bashkëpunim tregoi një kujdes të shtuar për të shmangur stigmatizimin duke zbatuar një qasje të ndjeshme ndaj familjeve të përfshira. Për këtë qëllim në projekt përveç 5 familje me histori udhëtimi drejt vendeve të luftës, u përfshinë dhe 4 familje vulnerabël. Ndërhyrjet janë fokusuar në disa aspekte kyçe, duke përfshirë mbështetjen psiko-sociale nga specialistë të shëndetit mendor, sigurimin e nevojave themelore të familjeve me paketa ushqimore, higjeno-sanitare , veshmbathje për gjithë anëtarët e familjes, mbështetje me medikamente sipas problematikave shëndetësore që këto individë kishin, sigurimin e mjeteve didaktike për fëmijët, ndihmën ligjore sipas rastit, ndihmën në ngritjen e bizneseve familjare, ndërmjetësimin për punësim, dhe referimin në institucione të tjera sipas nevojave të rastit.

Përveç ndihmës direkte të mundësuar familjeve, ky program kontribuoi dhe në ngritjen e kapaciteteve të personave përgjegjës për menaxhimin e rasteve të familjeve të personave të kthyer nga zonat e konfliktit. Ky është një shembull i suksesit të një përpjekje të përbashkët që synon të ndihmojë individët dhe familjet të përballojnë sfidat e rënda të ekstremizmit të dhunshëm dhe të radikalizmit në një mënyrë të qëndrueshme dhe të integruar në shoqëri.

Në vijim të analizës së përgjigjeve të dhëna në lidhje me *trajnimin e personelit të bashkive në kontekstin e parandalimit dhe kundërshtimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit*, duket qartë përpjekjet e ndërmarra nga bashkitë për rritjen e kapaciteteve duke përfshirë punonjësit e tyre në trajnime të ndryshme. Bashkia e Tiranës është një prej shembujve të praktikave të mira, pasi punonjësit social të qendrave komunitare dhe ata të Sektorit për Mbrotjtjen e Fëmijëve janë të angazhuar në trajnime specifike në lidhje me parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit. Kjo tregon një përkushtim të qartë ndaj krijimit të një mjedisi të trajnuar dhe të gatshëm për të kuptuar, identifikuar dhe adresuar rreziqet e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit.

Sa i përket Bashkisë së Kamzës, konstatohet se NjMF ka ndjekur vetëm një trajnim të organizuar nga USAID në lidhje me këtë fenomen. Gjithashtu, duke qënë se Bashkia Kamëz ka patur rritje të kapaciteteve të burimeve njerëzore në sektorin që menaxhon rastet që kane lidhje me radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm, theksohet nevoja për zhvillimin e trajnimeve periodike për të kuptuar dhe identifikuar shkaqet dhe pasojat e këtij fenomeni, duke pasur parasysh rolin specifik të secilit personel në menaxhimin e rasteve të ekstremizmit dhe radikalizmit.

Në rastin e Bashkisë së Pogradecit, tregohet se janë marrë trajnime të përgjithshme, por nuk janë organizuar trajnime për raste praktike për profesionistë të vijës së parë duke qënë se kjo bashki nuk ka patur raste të tilla. Kjo gjë ve në dukje nevojën për një fokus më të thellë në trajnimin e personelit në lidhje me ekstremizmin dhe radikalizmin, edhe pse aktualisht nuk ka pasur raste të tilla në bashkinë e tyre duke qënë se disa prej tyre gjenden akoma në zonat e konfliktit dhe kampet famëkeqe të Al-Hol.

Ndërsa, Bashkia Cërrik ka vendosur në fokus të trajnimeve NjMF për vetë rolin që kanë si menaxherë të rastit për fëmijët në nevojë për mbrotjtje përfshirë këtu dhe fëmijët e kthyer nga zonat e konfliktit, të radikalizuar ose në rrezik radikalizimi, duke i përfshirë në të gjitha trajnimet për këtë kategori. Gjithashtu trajnime të vazhdueshme kanë patur dhe punonjësit e vijës së parë si dhe personeli i Bashkisë Cërrik.

Lidhur me rolin dhe ndikimin që ka patur policimi në komunitet në rritjen e besimit dhe sigurisë në këto komunitete, përgjigjet e bashkive tregojnë se policimi në komunitet ka krijuar një

mjedis të ndërgjegjësuar dhe bashkëpunues, ndihmuan në adresimin e rasteve të ndryshme të sigurisë, dhe ndikuan pozitivisht në rritjen e besimit dhe sigurisë në komunitetet e tyre. Ky bashkëpunim strategjik ka shërbyer për të adresuar problematikat e ndryshme dhe për të rritur ndërgjegjësimin rreth sigurisë, duke bërë komunitetin më të pajisur për të parandaluar dhe trajtuar fenomene të rrezikshme si ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizmi.

Konkretisht, Bashkia e Tiranës vë në dukje bashkëpunimin e strukturave të njesisë së mbrojtjes së fëmijës me specialistët e policimit në komunitet. Në të njëjtën linjë, Bashkia e Kamzës vë në dukje se policimi në komunitet është një element kyç për rritjen e sigurisë. Ky bashkëpunim është vënë re në adresimin e problematika të ndryshme, përfshirë rastet e dhunës në familje, trafikimin e fëmijëve, abuzimin, shantazhin dhe raste të tjera që kanë të bëjnë me fëmijët në nevojë për mbrojtje.

Në përgjigjen e saj, Bashkia e Pogradecit, thekson rolin e rëndësishëm të policimit në komunitet dhe kontributin që japin banorët e këtyre komuniteteve. Komunikimi i vazhdueshëm me banorët dhe ndjekja e rasteve të ndryshme janë shprehur si elemente thelbësorë të këtij bashkëpunimi që kontribuojnë në sigurinë dhe parandalimin e fenomeneve të rrezikshme.

Po kështu Bashkia e Cërrikut vlerëson rolin e rëndësishëm që ka policimi në komunitet në rritjen e besimit dhe sigurisë. Eksperienca e kësaj bashkie ka treguar se trekendeshi polici-pushtet vendor- komunitet ka kontribuar në identifikimin dhe trajtimin e rasteve të identifikuar.

Përsa i përket *bashkëpunimit me shoqërinë civile*, përgjigjet e dhëna nga bashkitë e Tiranës, Kamzës, Pogradecit dhe Cërrikut, tregojnë një konsensus të përgjithshëm në vlerësimin e rolit të rëndësishëm të shoqërisë civile në ndërtimin e qëndrueshmërisë së komunitetit dhe përpjekjet për të luftuar fenomenin e radikalizmit dhe EDH. Shoqëria civile është njohur si një partner i rëndësishëm dhe efektiv në ndihmën për komunitetin në këto tre bashki.

Bashkia e Tiranës vë në dukje bashkëpunimin e ngushtë të strukturave të mbrojtjes së fëmijëve me organizatat e shoqërisë civile, duke identifikuar një ndikim pozitiv në qëndrueshmërinë e komunitetit.

Po kështu, Bashkia e Kamzës ka një historik të suksesshëm bashkëpunimi me shoqatat e shoqërisë civile dhe donatorë të ndryshëm për të rritur ndërgjegjësimin për dhunën në familje dhe pasojat e saj. Ky bashkëpunim ka kontribuar në rritjen e raportimit të rasteve të dhunës në familje në këtë bashki.

Ndërkohë që Bashkia e Pogradecit shprehet se shoqëria civile ka luajtur një rol të rëndësishëm në parandalimin e fenomeneve të ndryshme të dëmshme për komunitetin. Roli i shoqërisë civile më këtë qytet është evident në trajnimet e komunitetit dhe në përpjekjet për të adresuar sfida të ndryshme që lidhen me sigurinë dhe kundërshtimin e fenomenve të radikalizimit dhe EDH .

Të njëjtën qasje paraqet dhe Bashkia e Cërrikut e cila ka marrë hapa të rëndësishëm për përfshirjen e qytetarëve në çështje të përmirësimit të sigurisë publike duke i bërë pjesë të takimeve informuese dhe trajnimeve në komunitet të organizuara nga bashkia në bashkëpunim me organizata të ndryshme lokale duke krijuar njëplatformë komunikimi për dialog dhe bashkëpunim mes bashkisë dhe komunitetit për ti ndihmuar qytetarët të njihen më mirë me sfidat e sigurisë publike dhe me mënyrat se si ata mund të kontribuojnë në përmirësimin e saj. Gjithashtu në përgjigjen e saj kjo bashki thekson rëndësinë që ajo i jep bashkëpunimit me komunitetet fetare dhe shoqërisë civile. Ky bashkëpunim i gjerë është thelbësor për përmirësimin e sigurisë publike dhe për të ndërtuar një shoqëri më të sigurtë dhe të bashkuar në qytetin e Cërrikut.

Kur bëhet fjalë për rolin e trajnimeve në rritjen e kapaciteteve të profesionistëve dhe punonjësve të vijës së parë, dy bashkitë e Tiranës, Kamzës dhe Cërrikut pohojnë se trajnimet, të cilat janë mbështetur dhe nga donatorë të ndryshëm, kanë treguar se janë një mjet shumë efikas për të rritur kapacitetet e profesionistëve të vijës së parë.

Trajnime të ndryshme janë organizuar për personelin e bashkisë, shëndetësinë, policinë, dhe institucionet arsimore. Këto trajnime janë fokusuar kryesisht në trajtimin e rasteve, njohjen e legjislacionit, dhe zbatimin e protokolleve përkatëse. Ata kanë ndihmuar në thellimin e njohurive dhe në përmirësimin e përgjigjes ndaj viktimave të dhunës dhe krimit në përgjithësi dhe individëve të radikalizuar apo në rrezik radikalizimi.

Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se ky është një proces që duhet të vazhdojë me përkushtim dhe investime të vazhdueshme. Përditësimi i legjislacionit, ndryshimet në dinamikën shoqërore dhe sfidat e reja do të kërkojnë një përditësim të vazhdueshëm të kapaciteteve të profesionistëve të vijës së parë. Bashkitë duhet të vazhdojnë të investojnë në trajnime dhe të sigurojnë që profesionistët e vijës së parë të jetë gjithmonë të gatshëm për të përballuar sfidat e reja në fushën e tyre ndaj këtyre fenomeneve.

Një pyetje tjetër drejtuar institucioneve vendore ishte nëse ishin funksionale dhe efektive *Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike në kundërshtimin e fenomeneve të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm*. Bashkia e Tiranës nuk ka ngritur grupin vendor të sigurisë publike për të adresuar fenomenet e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm duke shfrytëzuar grupe pune ekzistuese. Në vend të kësaj, ata kanë ndërtuar mekanizma të

tjerë për të adresuar situata të ndryshme emergjente, si Grupet Teknike Ndërsektoriale për rastet e fëmijëve dhe Ekipet Teknike Ndërsektoriale për rastet e dhunës me bazë gjinore.

Kjo strategji duket se është e bazuar në një qasje më të fokusuar të trajtimit të rasteve të caktuara. Gjithsesi, ajo lë hapësirë për pyetje nëse këto mekanizma të specializuara janë të pajisura me njohuritë dhe burimet e nevojshme për të trajtuar edhe fenomenet më komplekse të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Në përfundim mund të themi se përgjigja e Bashkisë Tiranë lidhur me rolin e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike në kundërshtimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm tregon një qasje të ndryshme, me fokus në mekanizma të specializuara për situatat e veçanta. Ndërsa bashki të tjera të vogla e kanë ngritur KVSP-në duke e pare si një mekanizëm konsultues që mund ti ndihmojë ata në parandalimin e këtij fenomeni dhe në sigurinë e shtuar publike të territoreve të tyre. Megjithatë, diskutimi rreth funksionalitetit dhe efektivitetit të këtyre mekanizmave mbetet një sfidë e rëndësishme për të siguruar që komuniteti të mbrohet efikasht nga fenomenet e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm në të ardhmen.

Ndërsa përsa i përket Bashkisë së Çërrikut informacioni i dhënë tregon për një përpjekje të vendosur të kësaj bashkie për të adresuar këto sfida komplekse. Këshilli Vendor i Sigurisë Publike në Bashkinë Çërrik është themeluar në vitin 2017 dhe ka pasur takime të rregullta për trajtimin e çështjeve të sigurisë në vitet 2018-2019. Këshilli Vendor i Sigurisë ka një përbërje diverse me aktorë të ndryshëm duke përfshirë profesioniste të vijës së parë dhe është përqendruar në trajtimin individual me ndihmë psiko-sociale dhe mbështetje social-ekonomike, si dhe në programe komunitare dhe punësime start-up në bashkëpunim me partnerë të ndryshëm. Këto përpjekje të Këshillit tregojnë qëllimin për të ofruar ndihmë të përshtatshme për individët e prekur, si dhe iniciativat për trajtim komunitar dhe programet pilot shtojnë një dimension të shtuar në përpjekjet e kundërshtimit të ekstremizmit të dhunshëm.

Megjithatë, për të vlerësuar plotësisht efikasitetin e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike, është e rëndësishme të monitorohet dhe vlerësohet ndikimi i konkret i këtyre përpjekjeve në zvogëlimin e fenomeneve të radikalizimit dhe EDH në komunitet. Gjithashtu, duhet të sigurohet që bashkëpunimi me partnerët e ndryshëm është i qëndrueshëm dhe efikas në zgjidhjen e kësaj sfide të rëndësishme të sigurisë publike.

Praktika të vendeve të tjera të rajonit në riintegrimin e Luftëtarëve të Huaj të Kthyer dhe Personave të Radikalizuar ose në rrezik radikalizimi

Ky seksion paraqet një analizë të praktikave të mira të zbatuara nga disa vende të Ballkanit për riintegrimin e luftëtarëve të huaj të kthyer dhe personave të radikalizuar. Praktikrat e këtyre vendeve ofrojnë një pasqyrë të qasjeve të ndryshme të zbatuara nga këto vende në riintegrimin e luftëtarëve të huaj të kthyer si edhe individëve të radikalizuar ose në rrezik radikalizimi. Në mënyrë specifike ky seksion cilëson praktika të mira që kanë rezultuar të suksesshme në përballimin e sfidave të radikalizimit dhe terrorizmit.

Republika e Kosovës është një nga vendet e rajonit që ka qenë më e ekspozuar ndaj fenomenit të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm për shkak të një sërë faktorësh socio-ekonomikë dhe politikë, të cilët krijuan një terren të përshtatshëm për përhapjen e ideologjive radikale, veçanërisht në mesin e të rinjve të papunë dhe të marginalizuar. Mbi 400 burra, gra dhe fëmijë kosovarë kanë udhëtuar në zonat e konfliktit të armatosur në Siri dhe Irak. Rreth 70 prej tyre kanë humbur jetën, ndërsa për 130 prej tyre është bërë e mundur kthimi i tyre, edhe nëpërmjet riatdhesimit vullnetar. Kosova konsiderohet si një nga shembujt më të mirë në Ballkan për sa i përket numrit të individëve të kthyer, mes tyre dhe luftëtarë të huaj terroristë, dhe riintegrit të tyre. Ndërsa karakteristike për Kosovën është qasja e fortë policore, e mbështetur edhe nga masa rehabilituese dhe riintegruese, masat e marra në nivel ligjor, politikash dhe institucional, kanë dëshmuar qëndrueshmëri dhe përkushtim në luftën ndaj këtyre fenomeneve.

Kosova ka përmirësuar strukturën institucionale në drejtim të konsolidimit dhe koordinimit të përpjekjeve. Kjo strukturë përbëhet nga Koordinatori Kombëtar për Antiterrorizmin dhe Ekstremizmin e Dhunshëm, Policia e Kosovës nëpërmjet Drejtorisë së Anti-Terrorizmit, Agjencia e Inteligjencës Financiare si dhe Divizioni për Parandalim dhe Riintegrim. Krijimi i Divizionit për Parandalim dhe Riintegrim të Personave të Radikalizuar, në vitin 2018, ka përmirësuar ndjeshëm përpjekjet për riintegrimin e luftëtarëve të kthyer dhe parandalimin e radikalizimit. Këto struktura bashkëpunojnë për të luftuar terrorizmin dhe për të riintegruar të kthyerit në veçanti dhe individët e prekur ose në rrezik për tu prekur nga fenomenet e ekstremizmit dhe radikalizimit.

Fuqizimi institucional i Kosovës është mbështetur gjithashtu në një kornizë të plotë strategjike dhe ligjore për të adresuar ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin, siç është Strategjia Kombëtare për Parandalimin dhe Luftimin e Terrorizmit 2023-2028. Kjo strategji mbështetet në katër shtylla: Parandalimi, Mbrojtja, Ndjekja Penale dhe Reagimi, dhe reflekton qasjen shumëdimensionale dhe proaktive që Kosova ka adoptuar kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe në mbështetje të riintegrit efektiv dhe të qëndrueshëm.

Një praktikë e vlefshme për t'u ndjekur është bashkëpunimi i ngushtë i institucioneve publike të Kosovës me organizatat e shoqërisë civile dhe komunitetet vendore. Ky

bashkëpunim ka kontribuar në një qasje gjithëpërfshirëse dhe efektive, duke përfshirë komunitetet në proceset e parandalimit dhe riintegritit dhe duke krijuar rrjete mbështetëse për individët e radikalizuar ose në rrezik radikalizimi.

Bosnja dhe Hercegovina (BH) konsiderohet një praktikë e mirë për shkak të qasjes së saj të strukturuar dhe bashkëpunimit ndërsektorial për riatdhesimin dhe riintegritin e luftëtarëve të huaj të kthyer dhe personave të radikalizuar. Një nga sukseset kryesore është riatdhesimi i organizuar dhe i kontrolluar i individëve nga zonat e konfliktit, edhe me ndihmën e shërbimeve diplomatiko-konsullore. Në dhjetor 2019, BH realizoi riatdhesimin e grupit të parë nga Siria të 24 qytetarëve, prej të cilëve 7 burra, 6 gra dhe 11 fëmijë, të mbështetur me një proces të strukturuar të rehabilitimit dhe risocializimit, duke përfshirë masa të sigurisë dhe dokumentimin e identitetit.

Në vitin 2022, BH ka miratuar një plan të detajuar të riatdhesimit dhe një program të riintegritit, rehabilitimit dhe risocializimit të të kthyerve nga zonat e konfliktit të Sirisë dhe Irakut. Plani i riatdhesimit ka parashikuar në hollësi procedurat për kthimin e sigurt dhe të kontrolluar të qytetarëve të BH-së nga Siria dhe Iraku. Ky plan përfshin kontrollet e sigurisë, dokumentimin e identitetit dhe shtetësisë së personave që ishin objekt i riatdhesimit, si dhe ofrimin e ndihmës ligjore dhe humanitare për këta individë.

Programi i riintegritit, rehabilitimit dhe risocializimit, për të gjitha kategoritë e të kthyerve përmban masa afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të sigurisë. Ky program përfshin gjithashtu masa të mbrojtjes shëndetësore dhe sociale, sigurimin e qasjes në arsim, mbështetje ekonomike dhe punësim, ndihmë juridike në komunitetin vendor dhe masa të tjera të nevojshme.

Një instrument tjetër i rëndësishëm janë Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) që lehtësojnë dhe standardizojnë punën e profesionistëve në komunitetet lokale për rehabilitimin dhe riintegritin e të kthyerve dhe familjeve të tyre. Këto procedura janë fokusuar në rimëkëmbjen, mbështetjen shëndetësore dhe psikosociale, zhvillimin e mundësive arsimore dhe rikthimin në jetën familjare dhe komunitare.

Nga ana tjetër, i është kushtuar një rëndësi e veçantë dhe është punuar me përgatitjen e komunitetit dhe familjeve pritëse për të pranuar të kthyerit. Qendrat për punë sociale kanë luajtur një rol kyç në koordinimin e këtij procesi dhe në ofrimin e mbështetjes së nevojshme. Në procesin e riintegritit, rasti i BH ka dëshmuar rëndësinë që ka bashkëpunimi i ngushtë midis aktorëve dhe sektorëve të ndryshëm në të gjitha nivelet e qeverisjes. Bazuar në këtë qasje janë hartuar politika dhe programe të qëndrueshme që ofrojnë mbështetje për gratë, adoleshentët dhe fëmijët e kthyer nga zonat e konfliktit.

Përvoja e BH-së në koordinimin e aktorëve të shumtë dhe ndërtimin i një kornize të fuqishme strategjike dhe ligjore janë gjithashtu elemente kyçe që mund të adaptohen për të përmirësuar strategjitë e riintegritit në vende të tjera.

Një sfidë aktuale dhe e përgjithshme për profesionistët e të gjitha vendeve që presin të kthyerit nga zonat e luftës është regjistrimi i fëmijëve. Në rastin e të kthyerve në BH, pothuajse të gjithë këta fëmijë kishin lindur në Siri ose Irak dhe nuk ishin të pajisur me certifikatë lindjeje, dhe për këtë arsye legjislacioni në fuqi nuk krijonte mundësi regjistrimi. Zgjidhja që BH i ka dhënë këtij problemi është përmes amendimeve të akteve në fuqi që krijojnë mundësi për këta fëmijë të përfitonin shërbime edhe me statusin e paregjistruar. Megjithatë këta fëmijë në BH janë "të padukshëm" për sistemin e regjistrimit të qytetarëve, ata përfitojnë shërbim shëndetësor dhe mbrojtje sociale që në momentin e kthimit, falë bashkëpunimit ndërinstitucional të të gjithë aktorëve të përfshirë.

Përsa i përket *Republikës së Maqedonisë së Veriut*, ka bërë një progres të rëndësishëm në trajtimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe riintegrimin e luftëtarëve të huaj të kthyer duke u referuar si një praktikë e suksesshme. Që nga viti 2012, rreth 150 individë nga Maqedonia e Veriut janë larguar për në Siri dhe Irak, prej të cilëve 76 janë kthyer, 37 kanë humbur jetën dhe 17 janë ende në zonat e konfliktit. Aktualisht, 78 persona janë duke vuajtur dënime me burg për krime që lidhen me radikalizimin, përfshirë pjesëmarrjen në formacionet e huaja ushtarake, terrorizmin dhe kërcënimet ndaj rendit kushtetues. Maqedonia e Veriut ka arritur të kthejë me sukses disa qytetarë nga Siria dhe Iraku, përfshirë burra, gra dhe fëmijë duke u cilësuar si vendi i parë në rajon që riatdhedoi dhe njoftoi publikisht kthimin e luftëtarëve të huaj terroristë nga Siria. Ky proces ka qenë i mirë koordinuar dhe ka përfshirë bashkëpunimin e institucioneve të ndryshme, duke demonstruar një qasje efektive dhe gjithëpërfshirëse për riintegrimin e këtyre individëve.

Maqedonia e Veriut ka hartuar një kuadër ligjor gjithëpërfshirës për të luftuar krimin e organizuar dhe terrorizmin. Përparime të rëndësishme janë bërë në luftën kundër terrorizmit, veçanërisht në parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm. Vlen të përmendet strategjia e re kombëtare e Maqedonisë së Veriut për luftimin e terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm për vitet 2023-2027 e cila përfshin objektiva të qarta dhe plane veprimi të detajuara për të adresuar këto sfida. Këto objektiva përfshijnë parandalimin e radikalizimit, mbrojtjen e qytetarëve dhe institucioneve nga sulmet e mundshme terroriste, ndjekjen penale të personave të përfshirë në veprimtari terroriste dhe përforcimin e reagimit kombëtar ndaj kërcënimeve të terrorizmit. Strategjia është hartuar në përputhje me normat dhe standardet evropiane dhe është pjesë e përpjekjeve të përbashkëta rajonale në kuadër të Planit të Përbashkët të Veprimit për Kundër-Terrorizmin për Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë gjithashtu bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë për të garantuar një qasje të gjithanshme dhe efektive ndaj këtyre kërcënimeve.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm është ngritja dhe përfshirja e ekipeve multidisiplinare vendore, të cilat punojnë drejtpërdrejt me të kthyerit në rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre. Këto ekipe përfshijnë ekspertë nga profile të ndryshme, si punonjës socialë,

edukatorë, psikologë, udhëheqës fetarë dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare. Kjo strukturë e ekipeve lokale siguron një mbështetje të vazhdueshme dhe të personalizuar për të kthyerit dhe anëtarët e familjeve të tyre, duke i ndihmuar ata të risocializohen dhe të riintegrohen në komunitet.

Sikurse dhe shtete të tjera të rajonit, Maqedonia e Veriut miratoi në 2021, PSV për riintegrimin, risocializimin dhe rehabilitimin e të kthyerve dhe anëtarëve të familjeve të tyre të cilat përmbajnë objektivat, bazat, parimet dhe rekomandimet për trajtimin e grupeve të synuara, si dhe metodën e koordinimit institucional, si dhe një përmbledhje të masave dhe aktiviteteve sipas fazave të ndryshme të Planit Kombëtar.

Evolucioni i qasjes së Maqedonisë së Veriut për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm nënvizon zhvendosjen e vendit nga një politikë represive drejt një politike më strategjike dhe parandaluese. Qasja parandaluese është ndërtuar mbi analizimin ndërveprimit kompleks të çështjeve sociale dhe ndëretnike si elementë që kanë kontribuar në radikalizimin dhe adoptimin e ideologjive më konservatore kombëtare ose fetare nga disa segmente të popullsisë.

Këto hapa tregojnë përkushtimin e Maqedonisë së Veriut për të adresuar sfidat e lidhura me radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm në mënyrë sistematike dhe të mirëkoordinuar, duke e bërë atë një model të suksesshëm për integrimin dhe rehabilitimin e të kthyerve nga zonat e konfliktit.

Në lidhje me *Serbinë*, tema e deradikalizimit dhe riintegritit të personave të kthyer nga zonat e konfliktit është komplekse dhe e ndjeshme. Përvojat dhe praktikat në këtë fushë ndryshojnë nga vendi në vend dhe varësisht nga konteksti i konfliktit dhe politikave të ndryshme të vendit. Serbia ka hasur sfida të mëdha në trajtimin dhe riintegritit të personave të kthyer nga zonat e konfliktit, sidomos pas konflikteve të fundit në rajon. Ka pasur përpjekje për të implementuar politika dhe programe për riintegrimin e tyre në shoqëri, por është një proces që vazhdon të jetë sfidues dhe që ka nevojë për mbështetje dhe bashkëpunim ndërkombëtar.

Strategjia kombëtare për parandalimin dhe luftën kundër terrorizmit, e cila skadoi në vitin 2021, kishte mangësi të konsiderueshme dhe nuk arriti të trajtonte në mënyrë të duhur format më të përhapura të radikalizmit, si ekstremizmi i krahut të djathtë dhe ndikimi rus. Vlerësimi i kësaj strategjie dhe krijimi i një të re u shty për vitin 2022 dhe ende nuk është miratuar një strategji e re. Ligjet dhe rregulloret ekzistuese parashikojnë ndëshkime për pjesëmarrjen dhe organizimin e pjesëmarrjes së shtetasve serbë në konflikte të armatosura jashtë vendit, dhe dënimet për aktet terroriste janë bërë më të rrepta.

Serbia ka zhvilluar disa programe dhe trajnime për riintegrimin dhe deradikalizimin e individëve të radikalizuar, me mbështetje nga BE dhe SHBA. Megjithatë, ka mungesë të dhënash publike për programet e deradikalizimit gjatë burgimit ose pas lirit, dhe përpjekjet për riintegrim janë kufizuar vetëm tek individët që vuanin dënimin me burg, duke përjashtuar ata që kanë marrë dënime me kusht.

Strategjia gjithashtu anashkalon rolin e familjes, komunitetit dhe shoqërisë civile në proceset e rehabilitimit dhe riintegrimin, të cilat janë thelbësore për suksesin e këtyre përpjekjeve. Raporti i Komisionit Evropian i vitit 2023 rekomandon që Serbia duhet të bëjë përpjekje shtesë për të hetuar dhe ndjekur penalisht rrjetet e rekrutimit të luftëtarëve të huaj, të përmirësojë kapacitetin për të adresuar përmbajtjen terroriste dhe ekstremiste në internet dhe të fuqizojë shoqërinë civile për të zhvilluar kundër-narrativa efektive.

Në përfundim mund të thuhet se trajtimi i personave të kthyer nga zonat e konfliktit në Serbi mbetet një çështje e patrajtuar në mënyrë gjithëpërfshirëse. Nisur nga kompleksiteti i proceseve të rehabilitimit dhe riintegrimin të të kthyerve dhe individëve të tjerë të prekur nga fenomenet e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm, nevojitet një qasje shumëdimensionale dhe bashkëpunim ndërkombëtar për të adresuar sfidat dhe për të përmirësuar politikën dhe programet ekzistuese.

Gjetje dhe Rekomandime

Fenomenet e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit kanë adaptuar *forma të reja* ndaj është thelbësore që edhe legjislacioni dhe politikën kombëtare t'i përgjigjen nevojave në ndryshim të përgjigjes ndaj këtyre fenomeneve edhe në kuadër të përpjekjeve të përbashkëta ndërkombëtare për të luftuar kërcënimin global të terrorizmit dhe duke adaptuar praktika të mira të zbatuara nga vendet e tjera.

Rishikimi aktual i Kodit Penal tregon një përpjekje të vazhdueshme për të *përshtatur legjislacionin me kontekstin dhe format e përhapjes së fenomeneve të radikalizimit dhe EDH me qëllim për të siguruar mbrojtje efektive të individëve e shoqërisë nga këto fenomene*. Përmes ndryshimeve në Kodin Penal të miratuara në vitin 2012 dhe 2014, është synuar të adresohen në një farë mase kërcënimet e ekstremizmit dhe radikalizmit, duke dhënë parashikime të qarta për vepra të tilla dhe parashikuar dënime. Gjithsesi këto fenomene përbëjnë sfida të sigurisë për vendin e duhet të trajtohen në mënyrë adekuate dhe gjithëpërfshirëse. Rishikimi i pjesshëm i Kodit Penal nuk ka siguruar një qasje të tillë duke lënë jashtë kategori veprimesh që përbëjnë vepër penale siç është veprimtaria digjitale me përmbajtje ekstremiste dhe terroriste. Në këtë drejtim, rishikimi tërësor që po i bëhet Kodit Penal është një rast i mirë *për të adresuar në mënyrë adekuate dhe gjithëpërfshirëse këto fenomene*, bazuar në mësimet e nxjerra nga përvoja e viteve të

fundit por edhe praktikat e mira ndërkombëtare edhe në kuadër të procesit të përafrimit të legjislacionit me *acquis* të BE.

Individët shpesh radikalizohen dhe tërhiqen drejt veprimtarive ekstremiste dhe terroriste si rezultat i sfidave socio-ekonomike dhe situatave personale, të njohura si faktorë nxitës dhe tërheqës. Në këtë kontekst, është e rëndësishme që shteti, bashkë me aktorë të tjerë jo-publikë si media, komunitetet fetare dhe shoqëria civile, të angazhohen *në trajtimin e afatshkurtër dhe afatgjatë të shkaqeve që nxisin fenomenet ekstremiste*. Këto shkaqe përfshijnë mungesën e mundësive socio-ekonomike, marginalizimin, diskriminimin, qeverisjen e dobët, shkeljet e të drejtave të njeriut, situatat e sundimit të ligjit, konfliktet e zgjatura dhe të pazgjidhura, si dhe radikalizimin në burgje.

Në këtë përpjekje për të adresuar këto sfida, nuk duhet harruar *faktorë të tjerë të rëndësishëm që kontribuojnë në radikalizim*, duke përfshirë stimujt financiarë, propagandën në internet, shtrembërimin dhe keqpërdorimin e besimeve, ideologjive politike, dallimeve etnike dhe kulturore, si dhe rrjetet e rekrutimit personal në platformat sociale. Për të siguruar një përgjigje të suksesshme, duhet të zhvillohen *politika efektive, të cilat adresojnë këto shkaqe në një mënyrë integrale dhe koordinuar*. Vetëm përmes një përqasje të tillë të përbashkët dhe të koordinuar mund të ndërtohet një shoqëri e qëndrueshme dhe të shmangen pasojat e ekstremizmit

LHT dhe familjarët e tyre që kthehen nga zonat e konfliktit përmbushin njëherësh disa *faktorë vulnerabiliteti për shkak të rrethanave specifike dhe efekteve të traumës* dhe për këtë arsye përfitojnë nga mbrojtja dhe programet sociale dhe mbështetëse të rregulluara nga legjislacioni për mbështetjen dhe fuqizimin socio-ekonomik të grupeve të pafavorizuara por gjithmonë duke qënë në monitorim të vazhduar për sigurimin e rendit dhe sigurisë publike të komuniteteve ku vendosen përkohësisht ose përfundimisht, në përputhje me *legjislacionin dhe politikat për sigurinë dhe rendin publik*.

Në përputhje me rregullimet e legjislacionit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, gjatë procesit të rehabilitimit dhe riintegrit, *fëmijës duhet t'i sigurohen standardet më të larta të shëndetit, trajtimit, rehabilitimit dhe riintegrit dhe t'i ofrohet shërbim i personalizuar dhe specializuar, në përputhje me parimin e interesit më të lartë të fëmijës*. Në rastin e fëmijëve të kthyer duhet t'i garantohet stabilitet dhe vazhdimësi në shërbime shëndetësore, të mbrojtjes dhe edukimit, duke mbajtur parasysh formimin e tyre fetar kulturor dhe gjuhësor.

Statusi ligjor dhe shtetësia e fëmijëve të lindur në zonat e konfliktit, të cilët kanë udhëtuar në Shqipëri pa dokumentacionin përkatës është një çështje që duhet adresuar. Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm në lidhje me regjistrin e përkohshëm ofron një zgjidhje të ndërmjetme por jo të qëndrueshme për sa kohë që procedurat e vërtetimit të faktit dhe marrjes së vendimit përkatës nga gjykata për fëmijët e lindur në zonat e konfliktit dhe që

janë kthyer pa dokumentacion shoqëruar kalon në një procedurë të gjatë prej disa vitesh. Ndryshimet e bëra në ligjin për gjendjen civile²² hapin rrugën për mënyrën dhe afatet për regjistrimin e të lindurve në zonat e konfliktit por nuk e adresojnë rastin e fëmijëve të lindur në këto zona për arsye se i referohet rasteve kur ka një akt lindje të lëshuar jashtë vendit ndërsa në rastin e fëmijëve të lindur dhe të kthyer nga zonat e konfliktit nuk ka një akt të tillë.

Ruajtja e konfidencialitetit për të dhënat personale të individëve subjekt i proceseve rehabilituese dhe riintegruese është një aspekt delikat i cili kontribuon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në sigurimin e të drejtave të fëmijëve dhe të drejtat e njeriut gjatë procesit të riintegrit të tyre në shoqëri por edhe në suksesin e këtyre proceseve.

Edhe në rastet e ***fëmijëve pa shtetësi***, në përputhje me legjislacionin në fuqi, fëmija është bartës i të gjithë të drejtave që lidhen me mbrojtjen, zhvillimin dhe mirëqenien. Në kthimet e mëparshme ka patur dhe raste të fëmijëve të lindur në zonat e konfliktit, me të paktën një prind shqiptar të cilët kanë marrë asistencën ligjore falas nga ente të njohura nga shteti shqiptar. Fëmijës së kthyer i garantohet e drejta për të pasur një shtetësi, për të ruajtur identitetin dhe e drejta e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë. Respektimi i privatësisë së fëmijës është i rëndësishëm në çdo fazë të rehabilitimit dhe riintegrit të fëmijës së kthyer dhe cënimi i kësaj të drejte të fëmijës ndikon në mënyrë negative në ecurinë e këtyre proceseve.

Ngritja dhe funksionimi i ***Komiteteve Rajonale për Parandalimin e Radikalizimit dhe Luftën kundër EDH*** përfaqëson një zhvillim të rëndësishëm në drejtim të parandalimit, kundërshtimit dhe luftën kundër këtyre fenomeneve. Kjo njësi do të veprojë në nivel qarku për zbatimin e mekanizmit kombëtar të referimit pranë Koordinatorit Kombëtar për Parandalimin dhe Kundërshtimin e EDH dhe referimin pranë QKEDH të individëve apo grupeve të radikalizuara ose në rrezik radikalizimi.

Për shkak të përdorimit më të shtuar ***të mjedisit digjital për nxitjen e këtyre fenomeneve dhe rekrutimin e radikalizimin e individëve***, janë parashikuar ndërhyrje për një prezencë të strukturave të antiterrorit në mjedisin virtual, përmes kontrollit dhe monitorimit të hapësirave virtuale duke përfshirë hapësirën vështirësisht të depërtueshme të njohur ndryshe si *darknet*.

Zhvillimi i një komunikimi strategjik nëpërmjet rritjes së njohurive dhe ndërgjegjësimit të komuniteteve për këto fenomene me qëllim rritjen e reagimit dhe rezistencës së tyre

²² Neni 38/1, miratuar me Ligjin Nr. 69/2018, datë 11.10.2018 “Për disa shtesat dhe ndryshime në Ligjin Nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për Gjendjen Civile”, i ndryshuar”;

përfaqëson një element të rëndësishëm dhe me impakt të qëndrueshëm në parandalimin dhe kundërshtimin e fenomeneve të radikalizimit, EDH dhe terrorizmit.

Për arritjen e objektivave strategjike janë parashikuar ndërhyrje që lidhen me *rritjen e kapaciteteve të agjencive inteligjente dhe institucioneve ligjzbatuese* në drejtim të parandalimit, ndërprerjes së financimit të terrorizmit, vlerësimeve të riskut, analizave dhe kërkimeve për faktorët nxitës dhe format e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit. Masa të caktuara të strategjisë aktuale synojnë *rritjen e efektshmërisë së bashkëpunimit ndërinstitutional në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar*.

Përmirësimi i sistemeve të mbledhjes, ruajtjes, analizimit dhe shpërndarjes së informacionit është vlerësuar si një ndërhyrje e rëndësishme për sigurimin e mbajtjen në mënyrë të sigurt të informacionit, analizimin e tij dhe ndërveprimin efektiv me agjenci e institucione të tjera ligjzbatuese, brenda e jashtë vendit. Mënyra dhe frekuenca e shkëmbimit të informacioneve ndërmjet institucioneve të përfshira, nën koordinimin e qendrës CVE nevojitet *të rregullohet më anë të një akti normativ që përcakton drejtimet e ndarjes së informacionit që lidhet me individët e prekur nga fenomenet e EDH dhe radikalizimit dhe frekuencën e azhurnimit të informacionit*. Aktualisht shkëmbimi e azhurnimi i informacioneve të kësaj natyre ndodh në mënyrë sporadike ose me kërkesë të institucioneve të interesuara, të cilat megjithë kërkesën nuk e marrin në kohë dhe mënyrën e duhur informacionin e kërkuar.

Institucionet qendrore duhet të identifikojnë mangësitë dhe të kontribuojnë për të përmirësuar mekanizmat e ndërveprimit nëpërmjet miratimit të *Procedurave Standarde të Veprimit* tashmë të konsoliduara dhe ti vendosin këto ndërhyrje mbi bazë të parimeve e standardeve të unifikuara për të gjithë profesionistët e përfshirë.

Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm (P/CVE) në Shqipëri është një sfidë komplekse që mund të adresohet nëpërmjet fuqizimit dhe integritetit të shërbimeve mbështetëse dhe mbrojtëse, asistencës mjekësore dhe psikologjike, mundësive të punësimit, arsimimit, përfshirjes sociale. Një fokus i veçantë duhet të vendoset në komunitetet në rrezik, bazuar dhe në informacionin e siguruar nga QKEDH. Gjithashtu, ky komponent, dhe jo vetëm, duhet të shfrytëzojë risitë e inovacionit, logjistikës dhe mbështetjen për të kryer anketa dhe studime në Shqipëri dhe rajon.

Sipas legjislacionit serb, veçanërisht Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve, fëmijët duhet të përjashtohen nga kriminalizimi. Përkundrazi, ata duhet të ndihmohen për të gëzuar të gjitha të drejtat që u mohohen në ato kampe në mënyrën më skandaloze dhe traumatike. Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve dhe Protokollet e saj Fakultative theksojnë se fëmijët duhet të trajtohen gjithmonë kryesisht si viktimat dhe interesat e tyre më të mira duhet të respektohen gjithmonë.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka vendosur në disa raste se shtetet janë të detyruara të ushtrojnë kujdesin e duhur dhe të zbatojnë masa efektive për të mbrojtur individët e cënueshëm, veçanërisht gratë dhe fëmijët, të cilët janë jashtë territorit të tyre dhe rrezikojnë shkelje të rënda të të drejtave të njeriut. Shtetet duhet të sigurojnë që veprimet ose mosveprimet e tyre të mos cenojnë të drejtat e njeriut të këtyre individëve.

¹¹⁹ Sipas Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Anti-Terrorizmin, më shumë se 700 njerëz vdiqën në Al-Hol dhe Roj vetëm midis marsit 2019 dhe marsit 2021, të paktën gjysma e tyre fëmijë. Numri më i madh i tyre vdiqën nga sëmundje që mund të parandalohen dhe trajtohen. Dhuna me bazë gjinore është pjesë e jetës së përditshme, ndërkohë që ndonjëherë përdoren metoda brutale të ndëshkimit, si elektroshok.

¹²⁰ Raportet e vendit mbi terrorizmin 2022: Serbia, <https://ëëë.state.gov/reports/country-reports-on-terrorism-2022/serbia/>

¹²¹ Intervista të Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi me anëtarët e familjes

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi (HCHR) ka organizuar një seminar (dhjetor, 2022) për aktorët vendorë, institucionet dhe anëtarët e familjes, me qëllim që të përgatisë komunitetin për kthimin e grave dhe fëmijëve të mbetur nga kampet siriane. Asnjëri prej tyre, as anëtarët e familjes apo institucionet, nuk kanë është trajnuar më përpara, e as ka ndonjë përgatitje tjetër për të punuar me të kthyerit.

Kjo punëtori ka zbuluar se përfaqësuesit e institucioneve vendore (punëtorët socialë, stafi mjekësor dhe shkollat) nuk ishin të përgatitur në mënyrë adekuate për sfidat që lidhen me punën me të kthyerit. Përgatitje më e imtësishme do të jetë e nevojshme pasi riatdhesimi të bëhet i afërt dhe kur ai të fillojë¹²². Nga ana tjetër, përfaqësuesit e institucioneve kanë shfaqur interes për trajtimin e çështjes dhe për të ofruar ndihmë për të kthyerit në kuadër të kompetencave të tyre, si dhe për të bashkëpunuar me familjet e tyre.

Familjet e grave dhe fëmijëve kanë shprehur gatishmërinë e tyre për t'u ofruar të kthyerve kushtet e nevojshme materiale, duke përfshirë strehimin, si dhe mbështetjen sociale brenda familjes. Përveç kësaj, ata janë të gatshëm të bashkëpunojnë me institucionet, duke përfshirë ato ligjzbatuese.

Megjithatë, familjet nuk janë plotësisht të përgatitura psikologjikisht për ardhjen e grave dhe fëmijëve, pasi ende nuk janë gati t'u nënshtrohen përgatitjeve të thella për këtë proces. Ato janë ende të përqendruara në përpjekjet për të siguruar riatdhesimin e të afërmeve të tyre, duke kërkuar mbështetje nga institucionet për përpjekjet e tyre. Përgatitja e parakohshme konsiderohet e papërshtatshme pasi mund të krijojë pritshmëri joreale dhe të çojë në shqetësime të rënda në rast të vonesave ose riatdhesimit të pasuksesshëm. Rrjedhimisht, këto çështje duhet të trajtohen me kujdes maksimal, megjithëse pjesëmarrësve u ofrohen udhëzime dhe këshilla përkatëse në masën e mundshme.

Komuniteti më i gjerë vendor, nuk është i përgatitur për kthimin e grave dhe fëmijëve. Familjet dhe palët e interesuara vendore kanë shprehur shqetësimin për reagimet e mundshme të qytetarëve për ardhjen e të kthyerve në komunitetin vendor, duke theksuar se duhet shumë punë edhe në këtë drejtim. Sipas familjeve, fëmijët mbajnë stigmën e të qenët të lidhur me terrorizmin, pavarësisht nga përfshirja ose jo e tyre, dhe mund të përballen me refuzim dhe hakmarrje.

Duhet pasur parasysh se këto gra dhe fëmijë i përkasin komunitetit pakicë mysliman në Serbi. Ky komunitet ka qenë prej kohësh në shënjestër të stereotipeve të përhapura dhe është ekspozuar ndaj fushatave shoviniste dhe të krahut të djathtë gjatë dekadave. Rajoni i Sanxhakut¹²³, nga i cili shumica e tyre u nisën për në Siri, është nën mbikëqyrje të fortë nga shërbimet e zbatimit të ligjit dhe të sigurisë, kështu që rreziku i radikalizimit në këtë rajon është shumë i ulët.

¹²² Në seminar morën pjesë pjesëmarrës, përfaqësues të Qendrës vendore për Punë Sociale, shkollave, shërbimeve shëndetësore dhe shoqatës së psikologëve (dhjetor, 2022).

¹²³ Rajoni është Serbia Jugperëndimore me shumicë boshnjake/muslimane

Përfundim

- Serbia përballlet me radikalizim të rëndësishëm etnonacionalist të krahut të djathtë të lidhur me etnonacionalizmin serb dhe ndikimin malinj rus. Kjo paraqet rrezik të lartë të rritjes së rekrutimit për forcat ruse në Ukrainë. Megjithatë, institucionet kompetente duhet të ndërmarrin hetime të plota në rrjetet pro-ruse të rekrutimit që veprojnë në Serbi për të parandaluar regjistrimin e mëtejshëm.
- Serbia ndeshet me pengesa të konsiderueshme në përballjen me radikalizimin dhe terrorizmin për shkak të një mangësie thelbësore në përkushtimin politik dhe mungesës së dukshme të ekspertizës institucionale për nismat e deradikalizimit, rehabilitimit dhe riintegrit. Riintegrimi i suksesshëm mbështetet kryesisht në përpjekjet e vetë ish të burgosurve, familjeve të tyre dhe organizatave joqeveritare vendore.
- Ekziston një nevojë urgjente për riatdhesimin e qytetarëve serbë, veçanërisht grave dhe fëmijëve, nga kampet Al Hol dhe Roj. Për më tepër, është thelbësore të zbatohen programe për të lehtësuar riintegrimin e tyre të qetë dhe rilidhjen sociale.
- Duke u mbështetur nga praktikat e suksesshme brenda BE-së dhe rajonit të Ballkanit Perëndimor, Serbia duhet të zhvillojë programe të përshtatura për deradikalizimin, shkëputjen dhe riintegrimin. Këto programe duhet të adresojnë gjithashtu nevojat e individëve që kërkojnë të ndërpresin lidhjet me grupet ekstremiste të krahut të djathtë.
- Institucionet duhet të bashkëpunojnë ngushtësisht dhe sinqerisht me institucionet e BE-së, organizatat ndërkombëtare, OSHC-të vendore dhe ekspertët e pavarur.

KREU V

PRAKTIKA LEGJISLATIVE DHE INSTITUCIONALE NË REPUBLIKËN E BOSJNE- HERCEGOVINË

Sarajevë, shkurt 2023.

1. Korniza legislative në Bosnjë dhe Hercegovinë

“ Bosnja dhe Hercegovina e përballoi me sukses sfidën e kthimit të parë të organizuar të qytetarëve të BH nga zona e konfliktit në dhjetor 2019, kur, sipas vlerësimeve, u plotësuan kushtet për kthimin e grupit të parë të qytetarëve të BH nga Siria. Lidhur me këtë u imponua nevoja për një reagim të ngutshëm dhe sigurimin e kushteve të nevojshme për pranimin e tyre. Më 19 dhjetor 2019, nga Siria u riatdhesuan shtetas të BH, gjithsej 25 sosh: 7 burra, 6 gra dhe 11 fëmijë, si dhe një fëmijë i pashoqëruar. "Kthimi u zbatua me sukses në mënyrë të kontrolluar dhe në përputhje me legjislacionin pozitiv të BH-së dhe detyrimet e marra ndërkombëtarisht në fushën e luftës kundër terrorizmit, si dhe detyrimet e marra si pjesë e anëtarësimit të BH-së në koalicionin antiterrorizëm dhe anti ISIS."

Përvojat e fituara gjatë riatdhesimit, dhe pastaj riintegrit, rehabilitimit dhe risocializimit të të kthyerve nga zonat e konfliktit të Sirisë dhe Irakut janë shumë të rëndësishme në kontekstin e legjislacionit, strategjive, planeve dhe programeve që dolën nga ky proces.

Në seancën e 55-të të rregullt të mbajtur më 25 gusht 2022, Këshilli i Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës, me propozim të Ministrisë së Sigurisë së Bosnjës dhe Hercegovinës, mori një vendim për miratimin e Planit të Riatdhesimit dhe programit të riintegrit, rehabilitimit dhe risocializimit të qytetarëve të Bosnjës dhe Hercegovinës, të të kthyerve nga zonat e konfliktit të Sirisë dhe Irakut.

Plani i Riatdhesimit dhe Programi i Riintegrit, Rehabilitimit dhe Risocializimit të qytetarëve të Bosnjës dhe Hercegovinës që kthehen nga zonat e konfliktit të Sirisë dhe Irakut është rezultat i punës së Ekipit të Koordinimit për përgatitjen e procesit të riatdhesimit, riintegrit, rehabilitimit dhe risocializimit të qytetarëve të Bosnjës dhe Hercegovinës nga zonat e konfliktit të Sirisë dhe Irakut (në vijim: ekipi i koordinimit). Vetë procesi përfshin hartimin e:

Planit të riatdhesimit, i cili rregullon në hollësi procedurat për kthimin e sigurt, të njerëzishëm dhe të kontrolluar të qytetarëve të Bosnjës dhe Hercegovinës nga Siria dhe Iraku, kontrollet e sigurisë, dokumentimin e identitetit dhe shtetësisë së personave që janë objekt i riatdhesimit, ofrimin e ndihmës diplomatiko-konsullore, ligjore dhe humanitare për qytetarët e Bosnjës dhe Hercegovinës (në vijim: Plani); dhe

Programit të riintegrit, rehabilitimit dhe risocializimit për të gjitha kategoritë e qytetarëve të Bosnjës dhe Hercegovinës, i cili përmban masa afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të sigurisë, pastaj masa të mbrojtjes shëndetësore dhe sociale, sigurimin e qasjes në arsim, mbështetje ekonomike dhe punësim, ndihmë juridike në komunitetin vendor dhe masa të tjera të nevojshme (në vijim: Programi).

“Gjatë zhvillimit të planit dhe programit, ekipi koordinues është udhëhequr nga standardet ndërkombëtare, rregulloret ligjore të vlefshme në Bosnje dhe Hercegovinë dhe informacioni i Këshillit të Ministrave të Bosnje-Hercegovinës për qytetarët e Bosnje-Hercegovinës që ndodhen në zonën e konfliktit. Siria dhe Iraku dhe konkluzionet e miratuara me qëllim riatdhesimin e tyre, si dhe rekomandimet kryesore të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq në lidhje me riatdhesimin dhe riintegrimin e personave nga Siria dhe Iraku, gjithashtu në kuadër të detyrave dhe ndarjes sipas departamenteve, Ekipi Koordinues u nda në nëngrupe, përkatësisht:

- Nën-ekipi për aspektet e sigurisë së riatdhesimit dhe ndjekjes penale;
- Nën-ekipi për riintegrim, rehabilitim dhe risocializim.

Pas formimit të nëngrupeve, u caktuan detyra specifike dhe afate për ekzekutim në përputhje me veprimtaritë e planifikuara.

Ekipi i Koordinimit përbëhet nga përfaqësues të institucioneve/agjencive kompetente nga të gjitha nivelet e qeverisjes në Bosnjë dhe Hercegovinë, përfshirë: Ministrinë e Sigurisë të Bosnjës dhe Hercegovinës, Prokurorinë e Bosnjës dhe Hercegovinës, Ministrinë e Punëve të Jashtme të Bosnjës dhe Hercegovinës, Ministrinë e Çështjeve Civile të Bosnjës dhe Hercegovinës, Ministrinë e të Drejtave të Njeriut dhe Refugjatëve të Bosnjës dhe Hercegovinës, Ministrinë e Drejtësisë të Bosnjës dhe Hercegovinës, Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë të Bosnjës dhe Hercegovinës, Agjencinë Shtetërore për Hetimin dhe Mbrojtjen (SIPA), Policinë Kufitare të Bosnjës dhe Hercegovinës, Drejtorinë për Koordinimin e Trupave Policore, Administratën Policore Federale, Ministrinë e Punëve të Brendshme të Republikës Srpska, Policinë e Distriktit Brčko të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe entitetet dhe organet kompetente të Distriktit Brčko të Bosnjës dhe Hercegovinës në fushën e shëndetësisë, mbrojtjes sociale dhe arsimit.

Plani i Riatdhesimit dhe Programi i Riintegrit, Rehabilitimit dhe Risocializimit të qytetarëve të Bosnjës dhe Hercegovinës që kthehen nga zonat e konfliktit të Sirisë dhe Irakut janë miratuar për të siguruar kushtet e nevojshme për kthimin e sigurt, të njerëzishëm dhe të kontrolluar të qytetarëve të Bosnjës dhe Hercegovinës nga Siria dhe Iraku dhe riintegrimin, rehabilitimin dhe risocializimin e tyre.

Plani i riatdhesimit rregullon në hollësi procedurat për kthimin e sigurt, të njerëzishëm dhe të kontrolluar të qytetarëve të Bosnjës dhe Hercegovinës nga Siria dhe Iraku, kontrollet e sigurisë, përcaktimin e identitetit dhe shtetësisë së personave që janë objekt i riatdhesimit, ofrimin e ndihmës diplomatiko-konsullore, juridike dhe humanitare për qytetarët e Bosnjës dhe Hercegovinës.

Programi i riintegrit, rehabilitimit dhe risocializimit për të gjitha kategoritë e qytetarëve të Bosnjës dhe Hercegovinës përmban masa afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të sigurisë, pastaj masa të mbrojtjes shëndetësore dhe sociale, sigurimin e qasjes në arsim, mbështetje ekonomike dhe punësim, ndihmë juridike në komunitetin vendor dhe masa të tjera të nevojshme.

Plani dhe Programi gjithashtu përmban një pasqyrë të veprimtarive të deritanishme në trajtimin e të kthyerve nga zonat e konfliktit, përparimin dhe rezultatet, si dhe një mekanizëm monitorues dhe raportues që do të monitorojë zbatimin e tyre."

Në seancën e 210-të të mbajtur më 20 shkurt 2020, Qeveria e Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës miratoi një Vendim për emërimin e "Grupit të Punës Ndër-departamental të Qeverisë së Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës për Zhvillimin dhe Zbatimin e Planit të Veprimit për Parandalimin dhe Luftën kundër Terrorizmit në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës" (IRRG), i cili, ndër të tjera, kishte për detyrë të koordinonte veprimtaritë e lidhura me pritjen e të kthyerve nga fushëbetejat e huaja në koordinim me nivele më të ulëta të qeverisjes; të monitoronte zbatimin e masave të rehabilitimit psikologjik-sociologjik dhe përfshirjes, dhe të bashkëpunonte në këto veprimtari me Ministrinë e Sigurisë së Bosnjës dhe Hercegovinës, institucionet në nivelin e entiteteve dhe Distriktit Brčko të Bosnjës dhe Hercegovinës, kantonet dhe bashkitë, organizatat ndërkombëtare dhe joqeveritare.

Në këtë kontekst, me mbështetjen e Nismës Atlantike, IRRG zhvilloi "Protokollin për veprimin e institucioneve në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës në procesin e rehabilitimit dhe riintegrit të të kthyerve nga zona e konfliktit dhe familjeve të tyre".

Qëllimi i Protokollit është të përcaktojë parimet, rregullat dhe procedurat unike me të cilat institucionet dhe shërbimet kompetente në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës duhet të veprojnë, bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë informacion gjatë zbatimit të masave (të përbashkëta) dhe veprimtarive që synojnë rehabilitimin dhe riintegrimin e të kthyerve nga zonat e konfliktit. Me qëllim të zbatimit të Protokollit, IRRG inicioi formimin e Ekipeve Këshillimore Kantonale (KST) me një nismë me shkrim dhe një takim pune me kryeministrat kantonale në të cilën pritet kthimi i qytetarëve të Bosnjës dhe Hercegovinës nga zona e konfliktit, si dhe ekipet vendore (komunale) shumë-disiplinare (SVSh) për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, me

një nismë me shkrim dhe një takim pune me kryetarët e komunave ku pritet kthimi i qytetarëve nga zonat e konfliktit të Sirisë dhe Irakut.

Në përputhje me sa më sipër, IRRG, përmes qasjes së mësimave të nxjerra nga viti 2019 dhe në bashkëpunim me praktikuesit dhe ekspertët vendas në fushën e monitorimit dhe vlerësimit, ka zhvilluar procedura standarde operative që do të lehtësojnë punën e përfaqësuesve të ekipeve vendore shumë-disiplinare dhe do të mundësojnë një procesi të suksesshëm rehabilitimi, riintegrimi dhe risocializimi të të kthyerve dhe familjeve të tyre në komunitetin vendor."

Riintegrimi, rehabilitimi dhe risocializimi janë procese afatgjata dhe komplekse dhe kuptohet nevoja për të përmirësuar bashkëpunimin e një numri më të madh aktorësh dhe sektorësh në të gjitha nivelet e qeverisjes në Bosnje dhe Hercegovinë, si dhe nevoja për të krijuar politika dhe programe të qëndrueshme, me qëllim zbatimin sa më efektiv të proceseve të sipërpërmendura. Në përputhje me nevojën e deklaruar, u krijuan procedura standarde operative, të cilat do të lehtësojnë dhe standardizojnë punën e praktikuesve në komunitetet vendore për rehabilitimin dhe riintegrimin.

Procedurat standarde të funksionimit trajtojnë rëndësinë e rimëkëmbjes dhe mbështetjes shëndetësore dhe psikosociale, zhvillimin e mundësive të arsimit profesional dhe shkollor dhe rikthimin në jetën familjare dhe komunitare si shumë të rëndësishme për riintegrimin afatgjatë social dhe promovimin e të drejtave të tyre njerëzore.

Qëllimi i këtyre procedurave është të ofrojë udhëzime dhe hapa konkretë për të punuar me të kthyerit dhe familjet e tyre, duke ndjekur saktësisht të gjitha specifikat e tyre, përjetimin e traumave, interesin më të mirë të fëmijës, duke respektuar individualitetin e çdo rasti. Këto procedura janë një ndihmë e madhe për profesionistët kur punojnë me gratë, adoleshentët dhe fëmijët e kthyer nga zona e konfliktit, ku do të ndiqen parimet e një qasjeje të ndjeshme gjinore dhe interesat më të mira të fëmijës, të gjitha me qëllim të ofrimit të ndihmës adekuate dhe mbështetje për gratë, adoleshentët dhe fëmijët gjatë riintegritit dhe risocializimit në komunitetin vendor.

Fuqizimi socio-ekonomik dhe mbështetja psikosociale, synon të forcojë burimet individuale dhe të ndihmojë njerëzit të përballen me reagimet stresuese. Për të punuar me sukses në rehabilitimin dhe riintegrimin e të kthyerve dhe fëmijëve të tyre, praktikuesit nga komuniteti vendor, së bashku me nivelet më të larta të qeverisjes, duhet të ndërmarrin të gjitha hapat për të lehtësuar këtë proces. Gjithashtu, praktikuesit, në bashkëpunim me organizatat vendore joqeveritare dhe ndërkombëtare, duhet të kontribuojnë në krijimin e një mjedisi pozitiv në nivel të komunitetit vendor që do të kontribuojë në një proces më efektiv të riintegritit, risocializimit dhe

rehabilitimit. Nga ana tjetër, për rehabilitim të suksesshëm është e nevojshme të forcohet familja që pret gratë dhe fëmijët e të kthyerve.

Ekipi vendor multi-disiplinar i specifikuar në "Protokollin për veprimin e institucioneve në Federatën e Bosnjë-Hercegovinës në procesin e rehabilitimit dhe riintegrit të të kthyerve nga zona e konfliktit dhe familjeve të tyre" emërohet nga kryetari i komunës dhe përbëhet nga së paku tetë përfaqësues të shërbimeve profesionale të komunitetit: përfaqësues të komunës, komisariatit, qendrës për punë sociale, qendrës për shëndet mendor, shërbimeve profesionale të shkollave (pedagogë, psikologë apo mësues) ku shkojnë fëmijët e kthyer, përfaqësues të bashkësisë islame, përfaqësues të organizatave joqeveritare vendore dhe ofrues të ndihmës juridike falas.

Koordinator i të gjitha veprimtarive të renditura në dokument, por edhe udhëheqës i procesit të riintegrit të familjeve të të kthyerve nga zonat e konfliktit (që përfshin rehabilitimin, risocializimin dhe riintegrimin), do të jetë përfaqësuesi i Qendrës për Punë Sociale, i cili do të emërohet në ekipin multi-disiplinar vendor, me tregues se në të njëjtën kohë është drejtuesi i kursit. Drejtuesi i kursit koordinon dhe monitoron të gjitha veprimtaritë e nevojshme, në bashkëpunim me anëtarët e ekipit vendor shumë-disiplinar dhe institucionet e tjera nga komuniteti vendor, të cilët marrin pjesë në këtë proces. Menaxheri i rastit përfaqëson një pikë të vetme kontakti dhe koordinon të gjitha veprimtaritë me anëtarët e ekipit vendor shumë-disiplinar, organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet e tjera qeveritare për të cilat përcaktohet domosdoshmëria e pjesëmarrjes në përgatitjen dhe zbatimin e programit.

2. Një shembull i praktikës së mirë

"Pasi u plotësuan kushtet për kthimin e grupit të parë të qytetarëve të Bosnjës dhe Hercegovinës nga zonat e konfliktit të Sirisë dhe Irakut, dhe u imponua nevoja për një reagim urgjent dhe sigurimin e kushteve të nevojshme për pranimin e tyre, më 29 nëntor 2019, Presidenca e Bosnjës dhe Hercegovinës miratoi Përfundimin mbi nevojën për veprim të koordinuar të të gjitha strukturave kompetente për të siguruar kthimin e sigurt dhe të njerëzishëm, si dhe risocializimin e grupit të parë të grave dhe fëmijëve nga Siria.

Pas Përfundimit të miratuar, Ministria e Sigurisë së Bosnjës dhe Hercegovinës, në bashkëpunim me ministritë e tjera kompetente, nisi veprimtari fillestare lidhur me krijimin e supozimeve ligjore të mëtejshme për zbatimin e konkluzionit të Presidencës së Bosnjës dhe Hercegovinës.

Duke marrë parasysh se qe e nevojshme të sigurohej hapësirë për pritjen e këtyre personave pas mbërritjes në Bosnjë dhe Hercegovinë, me kërkesë të Ministrisë së Sigurisë së Bosnjës dhe Hercegovinës, më 6 dhjetor 2019, u mbajt një seancë e

jashtëzakonshme telefonike e Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës, ku u miratua konkluzioni: "Ministri i Sigurisë së Bosnjës dhe Hercegovinës është ngarkuar me marrjen e një Vendimi për vënien në dispozicion të kapaciteteve të Qendrës së Azilit në Delijaš për nevojat e pranimit dhe akomodimit të përkohshëm të qytetarëve të Bosnjës dhe Hercegovinës (gra dhe fëmijë) që kthehen nga Siria", dhe Vendimi i përmendur nga Ministri i Sigurisë u miratua në të njëjtën ditë.

Pas konfirmimit të identitetit të gjithsej 6 grave, 12 fëmijëve dhe 7 burrave (të cilët ishin në kërkim dhe u dorëzuan Prokurorisë së Bosnjës dhe Hercegovinës), dhe sigurimit të kushteve të nevojshme për transportin e tyre, u iniciuan veprimtari për të siguruar pritjen, identifikimin, kujdesin social dhe shëndetësor të të kthyerve me përfshirjen e plotë të të gjitha strukturave kompetente në Bosnjë dhe Hercegovinë në përputhje me kompetencat e përcaktuara me ligj.

Pas përfundimit me sukses të procesit të organizuar të riatdhesimit të qytetarëve të Bosnjës dhe Hercegovinës nga zonat e konfliktit, dhe qëndrimit nëntë-ditor të të kthyerve në Qendrën e Azilit, u plotësuan kushtet për kthimin e tyre në familjet e tyre, pra në adresat rezidenciale nga të cilat ata shkuan në zonat e konfliktit."

2.1. Përgatitja e familjes pritëse, komunitetit vendor dhe profesionistëve

Me kthimin e organizuar të familjeve nga fushëbetejat e Sirisë, institucionet, organizatat dhe organet e ndryshme në Bosnjë dhe Hercegovinë për herë të parë u përballën me sfida të ndryshme që duhej të adresoheshin, për të cilat nuk kishin zgjidhje sistemike të nevojshme, kapacitete profesionale, përvojë dhe burime.

Ishte e nevojshme të vlerësoheshin urgjentisht nevojat e familjeve të kthyer si dhe të familjeve pritëse, dhe të vlerësohej aftësia e komunitetit vendor për të përballuar sfidat e kthimit dhe për të përmbushur nevojat e tyre, si dhe të entiteteve të tjera dhe kapacitetet e tyre, të cilat mund të mbështesin si familjet e kthyer, ashtu edhe familjet pritëse. Një sfidë e veçantë ishte përgatitja e një plani mbështetjeje bazuar në një vlerësim gjithëpërfshirës të nevojave të të kthyerve dhe kapacitetit të sistemit për të përmbushur ato nevoja.

Koordinatori i të gjitha veprimtarive dhe bartësi i procesit të riintegrit të të kthyerve nga fushëbetejat e huaja (që përfshin rehabilitimin, risocializimin dhe riintegrimin) ishin qendrat për punë sociale.

Përgatitja dhe puna me një familje që ka shprehur gatishmërinë për të pranuar të kthyerit, është shumë e rëndësishme sepse familja përfaqëson një partner kyç në procesin e rehabilitimit dhe riintegrit. Prandaj, ishte e rëndësishme të merreshin informacion paraprak mbi vendndodhjen e të kthyerve dhe se kujt do t'i kthehen, për të

organizuar vlerësimin dhe përgatitjen për pranimin. Gjatë procesit të përgatitjes, familjet farefisnore përgatiteshin për faktin që të afërmit e tyre nuk do të jenë njëloj pas gjithë asaj që kanë përjetuar. Këto janë individë me shumë trauma që do të kenë nevojë për mbështetje të plotë. Veçanërisht për mbështetje do të kenë nevojë fëmijët që po vijnë dhe që kanë nevojë për një mjedis stimuluese, të sigurt dhe të qëndrueshëm për t'u rritur. Një pjesë e përgatitjes ishte njohja e tyre me llojin e mbështetjes që mund të presin në periudhën e ardhshme, si dhe me profilet e ekspertëve që do të punojnë me ta. Në disa raste, përveç përgatitjes psikosociale, që e nevojshme të ndërmerreshin hapa konkretë, si për shembull, pajisja dhe përshtatja e hapësirës për jetën familjare.

Përmes punës me këto familje, u bënë gjithashtu përgatitje për interesin e shtuar të medias, që pritej dhe që e kuptueshme. Familjeve iu shpjegua se media do të jetë ngulmuese dhe ndonjëherë irrituese, se raportimet mund të jenë gjithashtu pështjelluese, por se do duhëj të përballeshin gjithsesi me këtë.

Përgatitja e mjedisit/komunitetit vendor si një partner në këtë proces, rezultoi gjithashtu shumë e rëndësishme. Reagimet publike ndaj pritjes së të kthyerve në BH ishin të ndryshme dhe që e qartë se komuniteti vendor duhej të përgatitej. Në shembullin e Bosnjës dhe Hercegovinës, kjo nënkuptonte vizita tek komuniteti vendor dhe fqinjët e afërt, dhe bisedimin me ta, gjë që çoi në krijimin e njëfarë mirëkuptimi dhe thyerjen e stigmes për të kthyerit, dhe deri tani nuk kemi regjistruar asnjë incident.

Segmenti i tretë i rëndësishëm i përgatitjes është përgatitja e profesionistëve që do të punojnë me familjet. Në BH, situata ishte e tillë që Qendrat për Punë Sociale janë KOORDINATORËT e këtij procesi në komunitetet vendore sa herë që ka raste me rrezik të lartë, dhe sipas përshkrimit të vetë punës. Për këtë arsye, përpara mbërritjes së të kthyerve, QPS kontaktoi me institucionet vendore: bashkinë, Qendrën Shëndetësore, shkollën, në mënyrë që t'i njihje ata me situatën, t'i përgatiste për sfidat me të cilat përballen dhe të diskutonte bashkëpunimin e përbashkët.

2.2. Pranimi dhe mbështetja

Komunikimi me familjet e të kthyerve filloi me një ndërhyrje psikosociale dhe shëndetësore në aeroport, të ofruar nga përfaqësues të institucioneve të sistemit (institucione shëndetësore dhe sociale dhe agjenci të sigurisë), dhe vazhdoi me sigurimin e akomodimit të sigurt duke ofruar ushqim, veshje dhe këpucë, çka sigurisht ishte një bazë pozitive për mirëbesimin fillestar, pranimin dhe mirëkuptimin e ndërsjellë.

Gjatë qëndrimit të familjeve të kthyer në Qendrën e Azilit, vazhdoi sigurimi i ushqimit, pijeve, veshjeve dhe këpucëve dhe lodrave për fëmijët, dhe përfaqësuesit e institucioneve ofruan mbështetje psikosociale, në mënyrë që ata të ndiheshin sa më të

sigurt dhe të pranuar dhe të përshtateshin me mjedisin e ri në të cilin gjendeshin (sidomos fëmijët), dhe të eliminoreshin dyshimet dhe frikërat nga e panjohura, dënimi, stigma dhe paragjykimet që familjet prisnin.

Kontakti i parë/fillestar do të rezultojë shumë i rëndësishëm për krijimin e besimit midis punonjësve profesionalë nga njëra anë dhe anëtarëve të familjeve së kthyer (grave dhe fëmijëve) nga ana tjetër, dhe do të lehtësojë shumë punën e mëtejshme në terren dhe do të ndikojë në zhvillimin e mëtejshëm të besimit të përfaqësuesit e institucioneve të sistemit dhe në mbështetjen që ata ofrojnë. Kontakti i parë jo vetëm që i ofroi punonjësit social dhe psikologun nga Qendra për Punë Sociale (QPS) të dhëna të rëndësishme për vlerësimin e parë të nevojave urgjente, por gjithashtu i mundësoi atyre të vlerësonin gatishmërinë e tyre fillestare për bashkëpunim.

Përderisa ndër të kthyerit nga fushëbetejat siriane ishte gjithashtu një fëmijë pa kujdes prindëror për të cilin ishte planifikuar dhe përgatitur më parë vendosja në një familje kujdestare farefisnore, kujdestarët e mundshëm farefisnorë duhej të përgatiteshin për pranimin e tij.

Përgatitja përfshinte fuqizimin emocional për takimin e parë me fëmijën, informacion mbi humbjet dhe përvojat traumatike si pasojë e humbjeve, sjelljet që mund të priten, vonesat në zhvillim si pasojë e rrethanave të lindjes dhe jetesës, traumat e zhvendosjes dhe përballjen me rrethanat e reja në të cilat kthehet dhe në të cilat do të jetojë, nevojat që do të duhet të plotësohen, kapacitetet e sistemit për të ofruar mbështetje për plotësimin e nevojave.

Pavarësisht përgatitjeve dhe mbështetjes për familjen për pritjen e fëmijës, pas kthimit të fëmijës dhe ribashkimit me familjen kujdestare, që e nevojshme përfshirja e plotë e profesionistëve të QPS-së (marrja e fëmijës në aeroport dhe shoqërimi i fëmijës në adresën e banimit të familjes kujdestare, mbështetja psikologjike për fëmijën dhe familjen kujdestare gjatë ribashkimit dhe kontaktit të parë, informimi i fëmijës në përputhje me moshën e tij për çështjet për të cilat fëmija kishte nevojë për informacion të menjëhershëm, si dhe veprimet e tjera që lidhen me higjienën e fëmijës) për vendosjen e kontaktit dhe komunikimit të ndërsjellë pas bashkimit. Vendosja e kontaktit ndërmjet fëmijës dhe kujdestarit, pas ribashkimit, kërkoi praninë e punonjësve profesionistë të QPS për disa orë, pra, deri kur punonjësit profesionistë vlerësuan se ishin siguruar parakushtet për qëndrimin e fëmijës në familje pa praninë e tyre të mëtejshme fizike.

Për muajin e ardhshëm, nevojat e fëmijës kërkonin praninë e përditshme të profesionistëve të Qendrës për Punë Sociale (QPS) në adresën e fëmijës (vizita ditore në familje prej të paktën një ore) dhe mbështetje të vazhdueshme psikosociale njëzet e katër orë (të ofruar përmes telefonit ose duke vizituar familjen në adresë). Ishte

jashtëzakonisht e rëndësishme që gjatë muajit të parë të punohej vazhdimisht në vendosjen e një lidhjeje emocionale midis kujdestarit dhe fëmijës, përmes ofrimit të mbështetjes psikosociale dhe ndihmës.

Pas një muaji, sipas Planit të Mbrojtjes Individuale të Fëmijës (këtu e tutje: Plani), ofrimi i mbështetjes psikosociale vazhdoi në përputhje me Planin si dhe në përputhje me nevojat e jashtëzakonshme të familjes dhe fëmijës.

2.3. Vlerësimi i menjëhershëm i nevojave familjare dhe ndërhyrja

Gjatë qëndrimit të grave dhe fëmijëve në Qendrën e Azilit, ekspertët e QPS-së, në bashkëpunim me agjencitë e sigurisë, vizituan familjet pritëse për të vlerësuar: lidhjet dhe marrëdhëniet familjare, dinamikën e marrëdhënieve familjare, kohezionin familjar, zakonet dhe traditat familjare, nevojat e familjes (materiale, strehim, shëndetësi, arsim...) dhe të gjitha me qëllim krijimin e planeve të mbrojtjes emergjente mbi bazën e të cilave do të ofrohej mbështetje e menjëhershme, si për familjen e kthyer ashtu edhe për familjen pritëse, pavarësisht nëse është këshillimore, këshillim, mbështetje ligjore, psikologjike, materiale ose ndonjë lloj tjetër mbështetjeje emergjente.

Përveç vlerësimit të zonave të përmendura më parë, është bërë edhe një vlerësim i subjekteve kyçe në nivel të komunitetit vendor që mund të përfshihen në procesin e riintegrit, kapaciteteve të tyre dhe u identifikuan subjekte të tjera kyçe në nivel kantoni, të cilat gjithashtu mund të mbështesin riintegrimin.

Para kthimit të familjeve nga Qendra e Azilit në komunitetet vendore, janë hartuar planet e mbrojtjes emergjente. Planet e mbrojtjes emergjente shërbyen si udhëzime për veprime të mtejshme.

Menjëherë pas mbërritjes në familjen pritëse, me mbështetjen e organizatave joqeveritare familjeve të kthyer iu ofrua ndihma në formën e artikujve ushqimorë dhe higjienës. Ndihma u ofrua në atë mënyrë që familjet e të kthyerve, në bashkëpunim me një punonjës social, të bënin pazar në qendrat tregtare. Ndihma e punonjësës sociale në prokurim ishte e nevojshme sepse gratë që qëndruan në zonat e shkatërruara nga lufta për 6 vjet (nga të cilat shumica e tyre 3 vjet në kampe) pa kushte elementare të jetesës, nuk kishin mundësi të mësonin se si të drejtojnë një familje në mënyrë të pavarur dhe as nuk kanë mësuar se si të disponojnë burimet financiare.

Ishte hapi i parë drejt fuqizimit të grave për të marrë përgjegjësinë dhe për të menaxhuar në mënyrë të pavarur familjen e tyre. Përveç kësaj, ishte fillimi i krijimit të besimit dhe respektit të ndërsjellë.

Një formë tjetër ndihme ishte kujdesi shëndetësor për gratë, veçanërisht fëmijët. Menjëherë pas mbërritjes në vendbanimin, janë kryer ekzaminimet mjekësore të

fëmijëve dhe grave që kanë shprehur nevojën për të. Ekzaminimet janë bërë në qendrat shëndetësore vendore, pavarësisht se gratë dhe fëmijët nuk kanë pasur regjistrim të kujdesit shëndetësor atje.

Mbështetje psikosociale me qëllim: forcimin e kompetencave prindërore, krijimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve emocionale dhe lidhjeve sociale, zhvillimin e aftësive të ndryshme, përpunimin e përjetimit të humbjeve, ndryshimin e mënyrës së komunikimit me fëmijët dhe pjesëtarët e familjes, ofrohen nga KMF-të në vazhdimësi që nga momenti i kthimit të familjeve. Shërbimet e mbështetjes psikosociale u ofruan përmes kontakteve formale dhe joformale të punonjësve socialë dhe grave dhe fëmijëve. Kjo mbështetje nevojitej njëzet e katër orë në ditë për muajin e parë pas kthimit, dhe me ndryshimin e rrethanave në të cilat jetojnë familjet e kthyer me kalimin e kohës, intensiteti i mbështetjes u ul në atë mënyrë që përmes Planit të Mbështetjes, nevojat u dakordësuan, u planifikuan veprimtaritë dhe u punua për zbatimin e tyre.

Përveç shërbimeve të mbështetjes psikosociale, Qendra për Punë Sociale (QPS) vlerësoi nevojat materiale dhe shëndetësore të familjeve, dhe në përputhje me to ndërhyri në formën e ndihmës financiare një herëshe dhe të jashtëzakonshme, dhënies së të drejtës për ndihmë financiare të përhershme për familjet që plotësonin kushtet për të, sigurimin e akomodimit falas në institucionet parashkollë për fëmijët, sigurimin e pakove ushqimore dhe higjienike.

Ndërhyrjet më të zakonshme të ofruara për gratë dhe fëmijët e kthyer, janë këshillimi familjar dhe avokatia, vizitat te mjeku si për fëmijët ashtu dhe për të rriturit, puna për zhvillimin e marrëdhënieve midis anëtarëve të familjes dhe marrëdhënieve me mjedisin.

Është gjithashtu interesante të përmendet se është punuar intensivisht me të gjithë të kthyerit për zhvillimin e aftësive të jetës dhe kompetencave të prindërimit. Këto gra u larguan nga Bosnja dhe Hercegovina shumë të reja dhe u kthyen si gra dhe nëna, gra që drejtojnë familjen - role që nuk vijnë natyrshëm për të gjithë, por që mësohen dhe përmirësohen.

Përvojat që shërbyen në krijimin e dokumenteve dhe strategjive në Bosnjë dhe Hercegovinë tregojnë se duhet të ketë një menaxher të rastit kur punohet me të kthyerit. Prandaj, duhet të jetë i njëjti person në QPS që do të punojë me familjet dhe që do të jetë kontakti i tyre i drejtpërdrejtë, në mënyrë që familjet të dinë saktësisht se kujt mund t'i drejtohen gjithmonë, të kërkojnë ndihmë, mbështetje, të bisedojnë... Në këtë mënyrë, zhvillohet besimi i ndërsjellë, respekti, një marrëdhënie që do të jetë shumë e rëndësishme për punën e mëtejshme.

Është gjithashtu një avantazh i madh në procesin e rehabilitimit dhe riintegrit të të kthyerëve nëse Menaxheri i Rastit është një grua. Përvoja na ka treguar se është më e

lehtë dhe më e pranueshme për të kthyerit të flasin me një grua tjetër, është më e lehtë të krijohet një ndjenjë besimi, është më e lehtë të ndahen gjëra të ndjeshme që lidhen me fëmijët, familjen, përvojat traumatike ndaj të cilave ato kanë qenë të ekspozuara.

Besimi nuk krijohet brenda natës, është një proces në vazhdim, dhe në rastin e Bosnjës dhe Hercegovinës u krijua falë hapjes sonë dhe kontakteve të shpeshta me të kthyerit. Mesatarisht, këto janë kontakte personale disa herë në javë, të cilat zakonisht zhvilloheshin në një mjedis që ata e njihnin, ku ndiheshin të sigurt dhe të mbrojtur, kështu që ishin të gatshëm të ndanin përvojat dhe frikërat e tyre.

Ndonjëherë, në punën me të kthyerit, gjatë bisedës, profesionistët hasnin në qëndrime, mendime ose vendime të ngjyrosura nga pikëpamjet teologjiko-ideologjike, që ndonjëherë nuk ishin të qarta për ta si profesionistë të mbrojtjes sociale. Në situata të tilla, profesionistët siguroheshin të kërkonin sqarime nga ekspertë të tjerë. Fatmirësisht, ata kanë zyrtarë fetarë në komunitetin vendor të gatshëm të shpjegojnë disa nga qëndrimet dhe mënyrën se si komuniteti të cilit i përkasin këto gra, i kupton dhe i shpjegon ato.

Në fund të gjashtë muajve që nga kthimi nga fushëbetejat siriane, QPS koordinoi ofrimin e shërbimeve terapeutike për familjet e kthyer, familjet kujdestare dhe fëmijët pa kujdes prindëror. Ky shërbim iu ofrua grave përmes punës në grup, dhe familjeve kujdestare dhe fëmijëve pa kujdes prindëror përmes punës individuale.

2.4. Plani afatgjatë i mbrojtjes

Planet individuale të mbrojtjes hartohen një muaj pas mbërritjes së familjeve bazuar në një vlerësim gjithëpërfshirës të kryer më parë të nevojave individuale të secilit pjesëtar të familjes, si të familjes së kthyer ashtu edhe të familjes pritëse. Është e rëndësishme të theksohet se qëndrimi i barabartë ndaj familjes së mbërritjes, si dhe ndaj familjes pritëse dhe angazhimi i komunitetit vendor për të mbështetur familjet, ka kontribuar në zhvillimin e lidhjeve sociale midis familjeve të kthyer dhe komunitetit në përgjithësi, si dhe hapja e familjeve ndaj “botës së jashtme”, e cila nuk do të ishte e mundur pa ndihmën dhe mbështetjen që u përdor nga fondet e organizatave joqeveritare.

Planet individuale të mbrojtjes parashikojnë bashkëpunim të vazhdueshëm me familjet e kthyer dhe familjet pritëse, me subjekte të tjera të komunitetit vendor dhe veprimtari të ndryshme, mbajtësit e tyre dhe afatet për zbatimin e tyre.

Në përgatitjen e planeve mbështetëse në komunitetin vendor, si faktorë të rëndësishëm në procesin e riintegrit u njohën: qendrat shëndetësore, punëtorët profesionistë në qendrat e shëndetit mendor, organet administrative komunale, kopshtet, shkollat, komunitetet fetare ku bëjnë pjesë të kthyerit, shërbimet e punësimit, departamentet e

policisë, organizatat joqeveritare, shoqatat etj. Qendrat për punë sociale shfrytëzuan maksimalisht shërbimet e burimeve të përmendura.

Disa prej tyre janë:

- Mirëkuptimi dhe mbështetja e drejtorëve të qendrave shëndetësore për ekzaminime urgjente mjekësore dhe trajtim të anëtarëve të familjes (përcaktohet terapia e rregullt e përdorur nga gratë e kthyer dhe ofrohet trajtim i rregullt nga psikiatër dhe psikologë në qendrën e shëndetit mendor),
- Gatishmëria për të bashkëpunuar me bashkitë në procedurat për lëshimin e dokumenteve personale dhe njohjen e të drejtës për sigurim shëndetësor për gratë e kthyer;
- Gatishmëria e zyrave të gjendjes civile nëpër komuna për të nisur procedurat për regjistrimin e fëmijëve në amzë, për të cilën fatkeqësisht nuk është gjetur baza ligjore.
- Gatishmëria e shkollave për pranimin e fëmijëve pa dokumente në procesin arsimor,
- Gatishmëria e institucioneve parashkollore për t'u kujdesur për fëmijët pavarësisht mungesës së dokumenteve dhe gatishmëria e tyre për të ofruar shërbime të akomodimit të fëmijëve pa pagesë.

QPS-ja sipas detyrës zyrtare ka iniciuar procedurat për realizimin e të drejtës në ndihmë të përhershme financiare në bazë të paaftësisë aktuale për punë të grave të kthyer, kështu që kjo e drejtë është rregulluar edhe për një vit, gjë që i ka dhënë grave siguri shtesë për plotësimin e nevojave të familjes.

Fëmija pa përkujdesje prindërore dhe familja kujdestare në të cilën ai është vendosur, kanë të drejtën e kompensimit për mbështetjen e fëmijës dhe kompensimin për punën e kujdestarit, i cili në një farë mënyre garanton sigurinë e fëmijës.

3. Sfida

Përveç pikëpyetjeve teologjike dhe ideologjike, një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballen profesionistët është regjistrimi i fëmijëve në regjistrat e amzës dhe në regjistrat e shtetasve të BH-së. Duke pasur parasysh se pothuajse të gjithë këta fëmijë kanë lindur në Siri dhe nuk kanë certifikatë lindjeje, legjislacioni i BH nuk i njeh ata si të tillë. Zgjidhja e vetme ishte ndryshimi i Rregullores përmes amendimeve, gjë që ndodhi. Duhet theksuar se këta fëmijë gëzojnë ende mbrojtje shëndetësore dhe sociale që në momentin e kthimit falë bashkëpunimit me aktorë të tjerë, pavarësisht se janë “të padukshëm” për sistemin. Megjithatë, për të siguruar mbrojtjen afatgjatë të fëmijëve dhe akses në të gjitha shërbimet, është e nevojshme të rregullohet statusi i tyre.

Një sfidë tjetër është kohëzgjatja e gjatë e procesit të rehabilitimit dhe riintegrit - të gjithë duhet të jemi të vetëdijshëm se ndryshimet nuk do të ndodhin brenda natës dhe se puna me të kthyerit, të rriturit dhe fëmijët do të zgjasë me vite, se ata do të mbartin shumë dyshime, ulje dhe ngritje, por me synimin për një rehabilitim dhe riintegrim të suksesshëm dhe përfshirjen e tyre të plotë në shoqëri, kjo është një përpjekje që duhet të përballojmë të gjithë së bashku.

Një tjetër gjë që duhet përmendur është se nuk ka zgjidhje universale dhe as qasje universale për të kthyerit. Qasja në punën me të kthyerit duhet të jetë individuale dhe t'u përshtatet atyre sepse të gjithë kanë histori të ndryshme jete, mjedise të ndryshme familjare, dinamika të ndryshme familjare, pika të forta dhe të dobëta, dhe për këtë arsye qasja dhe ndërhyrjet tona ndryshojnë nga rasti në rast.

Ky ishte grupi i parë i organizuar i të kthyerve në Bosnje dhe Hercegovinë dhe pas katër vitesh ne jemi në gjendje të përdorim përvojat dhe mësimet tona gjatë punës me ta për të përgatitur pritjen e grupeve të ardhshme të të kthyerve, si dhe për të ndarë përvojat tona me ata që ende nuk e kanë bërë këtë detyrë.